# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5507
E premte, 22 qershor 2018
çmimi 0.40 €


## Kalueshmëria e testit të maturës, 73.3 për qind

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", AGON MALIQI FAQE 4-5

# Opozita nuk duhet të tregohet refuzuese dhe inatçore



Analisti politik Agon Maliqi ka thënë se politikës shqiptare i mungon mendësia shtetformuese, prandaj partitë politikë janë larg arritjes së konsensusit për çështje të interesit kombëtar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se çdo gjë shihet nga prizmi i kalkulimeve politike dhe inateve. Maliqi ka thënë se opozita nuk duhet të tregohet refuzuese dhe inatçore karshi dialogut me Serbinë. Në këtë drejtim, sipas tij, si pikënisje duhet të jetë një platformë e përbashkët me vija të kuqe dhe konsensusi në grupin e unitetit dhe pastaj nuk ka rëndësi se kush u prinë bisedimeve. Maliqi ka vlerësuar se Kosova nuk ka qeveri dhe lidership me kapacitet shtetformues dhe me agjendë të qartë zhvillimore. Ai ka thënë se sundon njëfarë mendësie zhvatëse dhe provinciale



## Apostolova kërkon tërheqjen e vendimit për rritjen e pagave për qeveritarët

Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, Nataliya Apostolova, në një deklaratë për media ka theksuar se vendimi i Qeverisë së Kosovës për rritje të pagave duhet të tërhiqet dhe të pritet miratimi i ligjit të ri për pagat. Ndërkaq shefi i kabinetit të kryeministrit, Avni Arifi, ka reaguar ndaj deklaratës së Apostolovës lidhur me vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave për vetveten. Ai ka theksuar se vendimi i Qeverisë së Kosovës për ngritjen e pagave është legal, legjitim dhe kushtetues FAQE 9

## Kurti: Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja



Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se Qeveria për çdo javë bën nga një skandal. Ai ka kritikuar Qeverinë edhe për mungesë legjitimiteti në Kuvend. Sipas Kurtit, kryeministri Haradinaj duhet ta testojë Qeverinë e tij me mocion votëbesimi në Kuvend. Ai ka thënë se Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja dhe të lira ngaqë nuk ka demokraci me qeveri të pakicës.

## AKTUALE



**E KENI SJELLË KOSOVËN BUZË DËSHTIMIT** F. 13

Prof. dr. Hakif BAJRAMI

**FILLUAN PUNËN 18 SPECIALISTË TË RI NË SPITALET E PËRGJITHSHME** F. 7

**HELLMICHI: KOSOVA MUND TË LLOGARITË NË MBËSHTETJEN E GJERMANISË** F. 6

## EKONOMI

**LIMAJ: NDIHMA E FMN-së ËSHTË E RËNDËSISHME PËR KOSOVËN** F. 8

**LEKAJ E MARKUSZ BISEDOJNË PËR PROJEKTET INFRASTRUKTURORE** F. 8

## KULTURË

**LIBËR I SHKRUAR ME KOMPETENCË DHE PËRGJEGJËSI HISTORIKE** F. 13

Ismet RASHITI

## SPORT

**SHQIPET E ZVICRËS SOT PËRBALLEN ME SERBINË** F. 18

**VESELI: PUNA E VOKRRIT, MODEL PËR GJENERATAT E REJA** F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Pacolli kërkon mbështetjen e Lihtenshtajnit për liberalizimin e vizave

Ministri i Jashtëm, Begjet Pacolli ka kërkuar nga Lihtenshtajni mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në organizata evropiane dhe ndërkombëtare si dhe kontributin e mundshëm të këtij shteti për liberalizimin e vizave, megjithëse ky vend nuk është anëtarë i BE-së, por vetëm i zonës Schengen



PRISHTINË, 21 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka takuar ministren për Punë të Jashtme, Drejtësi dhe Kulturë të Principatës së Lihtenshtajnit, Aurelia Frick.
Thellimi i marrëdhënieve bilaterale, liberalizimi i vizave, anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare, avancimi i agjendës evropiane dhe dialogu me Serbinë kanë qenë disa nga temat kryesore të këtij takimi në mes krerëve të diplomacisë nga të dyja vendet.
Ministri Pacolli ka falënderuar Principatën e Lihtenshtajnit për mbështetjen e vazhdueshme dhe të palëkundur ndaj shtetit të Kosovës, duke shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e institucioneve të vendit për të thelluar dhe zgjeruar edhe më shumë bashkëpunimin dhe partneritetin institucional në mes dy vendeve nëpërmjet inicimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të reja që do të hapnin mundësi të reja.
Pacolli ka kërkuar mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në organizata evropiane dhe ndërkombëtare si dhe kontributin e mundshëm të këtij shteti në lidhje me liberalizimin e vizave, megjithëse ky vend nuk është anëtarë i BE-së, por vetëm i zonës Schengen.
Pas përfundimit të vizitës dhe takimeve në Principatën e Lihtenshtajnit, shefi i diplomacisë kosovare do të vazhdojë vizitën e tij në Konfederatën zvicerane sot (e premte) ku do të pritet nga shefi i Departamentit për Pune të Jashtme, Ignazo Cassis.

# Fleckenstein: Gjermania pro nisjes së negociatave me Shqiprinë



BERLIN, 21 QERSHOR - "Nuk jepen negociata me vënie kushtesh për kampe refugjatësh, do të ishte e padrejtë", thotë në një intervistë për "Deutsche Ëelle", raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein.
Finalja e debatit disajavor po afron dhe socialdemokrati gjerman nuk e thotë dot saktësisht nëse negociatat do të hapen apo jo, e pohon se diskutimi vazhdon pasi ka rezerva, sidomos nga pala franceze, e cila i mëshon idesë se BE-ja duhet të reformohet një herë vetë, pastaj të mendojë zgjerimin e mëtejshëm.
Por, Fleckensteini pohon se ka sinjale shumë të qarta nga zyra e Kancelares se, Gjermania do të thotë një "po" të qartë për bisedimet e anëtarësimit.
"Nëse do të flitet për kushte, sqaron ai, ato do të lidheshin me procesin e vettingut dhe nevojën për të treguar se ai do të vazhdojë dhe se reforma në drejtësi nuk po bëhet vetëm për të marrë 'dritën jeshile' të çeljes së negociatave".
I pyetur nëse do të ketë edhe një kusht tjetër, atë që diskutohet ethshëm prej ditësh tashmë, që Shqipërisë t'i kërkohet të pranojë kampe refugjatësh në territorin e saj, përgjigjja është se në këtë samit do të trajtohen çështje të ndryshme, përfshirë atë të emigracionit, e në këtë kontekst mund të ketë gjithmonë kompromise mes 28 vendeve të Bashkimit Evropian, të cilat dalin përtej kufijve të territorit në fjalë.
"As nuk mund ta përjashtoj, por as nuk e përfytyroj dot, sepse nuk i njoh detajet", shprehet Fleckenstein, duke theksuar se ai vetë, Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian shohin progres në procesin e vettingut, e kjo konsiderohet shpresëdhënëse, duke sjellë një miratim të gjerë në të dy këto organizma.

# Bushati në Rodos takon homologun grek Kotzias




TIRANË, 21 QERSHOR - Në Rodos të Greqisë ka filluar Konferenca e 3-të për Sigurinë dhe Stabilitetin, me pjesëmarrjen e 25 përfaqësive nga vendet e Evropës Juglindore, të Mesdheut, të Lindjes së Mesme, OKB-së, Organizmit për Bashkëpunimin e Vendeve Arabe, si dhe vëzhguesve nga Vietnami, Kolumbia dhe Indonezia.
Në konferencë merr pjesë edhe ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ditmir Bushati, i cili do të takohet në kuadër të saj edhe me homologun e tij grek, Nikos Kotzias.
I pyetur për këtë takim gjatë mbërritjes së tij në sallën e konferencës, Bushati ka deklaruar: "Është edhe ky takim (me Kotziasin) pjesë e vizitës sime këtu. Ne po diskutojmë dhe do të vazhdojmë të diskutojmë me mikun tim, Nikos Kotzias, për agjendën dypalëshe. Siç e dini, ne kemi bërë progres thelbësor në shumë çështje kohët e fundit".
Në mediet greke është bërë tashmë i njohur lajmi se, Athina zyrtare do të përfundojë brenda pak kohësh edhe paketën e çështjeve me Shqipërinë, pas nënshkrimit të marrëveshjes së Prespës, që arritën Athina dhe Shkupi në lidhje me çështjen e emrit të fqinjit verior të Greqisë.

# Xhafaj në Berlin takon Seehofer



TIRANË, 21 QERSHOR - Ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Fatmir Xhafaj ka zhvilluar një takim të enjten në Berlin me ministrin Federal të Brendshëm, Horst Seehofer.
Me anë të një postimi në "Twitter", Xhafaj e vlerësoi takimin shumë miqësor dhe produktiv, duke thënë se Gjermania mbështet integrimin e Shqipërisë në BE.
"Bashkë me drejtues të lartë të PSH në vizitë zyrtare në Gjermani. Mirënjohje dhe falënderim për mbështetjen e plotë dhe të drejtpërdrejtë që partnerët gjermanë i japin Policisë në luftën kundër krimit. Rikonfirmim i dyanshëm i angazhimit për thellim të bashkëpunimit, tani dhe në të ardhmen.
Sapo përfundova një takim shumë miqësor dhe produktiv me ministrin e Brendshëm Federal, Seehofer. Gjermania mbështet integrimin e Shqipërisë në BE. Dritë jeshile për hapjen e negociatave. Seehofer në gjurmët e paraardhësit të tij F.J.Strauss. Mirënjohje pafund Gjermanisë mike!", shkroi Xhafaj në Twitter.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka mbajtur konferencë për medie

# Kurti: Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se Qeveria për çdo javë bën nga një skandal. Ai ka kritikuar Qeverinë edhe për mungesë legjitimiteti në Kuvend. Sipas Kurtit, kryeministri Haradinaj duhet ta testojë Qeverinë e tij me mocion votëbesimi në Kuvend. Ai ka thënë se Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja dhe të lira ngaqë nuk ka demokraci me qeveri të pakicës




EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 21 qershor** - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, sërish e ka kritikuar Qeverinë për mungesën e shumicës në Kuvend. Në një konferencë për medie, ai ka kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinaj për t'u hapur rrugë zgjedhjeve të reja. "Ndodhemi në një situatë në të cilën nuk mund të kemi demokraci sepse kemi qeveri të pakicës. Numri i partive në koalicionin qeverisës është dyfish më i madh sesa numri i deputetëve të partisë së kryeministrit. Ne kemi kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Haradinaj i cili për çdo javë bën, së paku, nga një skandal. Ai duhet ta testojë Qeverinë me votëbesim në Kuvend. Kosova nuk mund ta bëjë shtetndërtimin pa demokraci. E nuk ka demokraci me qeveri të pakicës. Kemi nevojë për zgjedhje të reja e të lira", ka deklaruar Kurti.

Ai ia ka përmendur kryeministrit sërish demarkacionin me Malin e Zi, duke thënë se kreu i Qeverisë tashmë e ka heshtur këtë çështje. "Sot janë bërë saktësisht tre muaj të ratifikimit në Kuvend të demarkacionit me Malin e Zi. Edhe pas tre muajve nuk ka asnjë lëvizje lidhur me atë çfarë kryeministri ka thënë para Kuvendit sa i përket korrigjimit sipas raportit të Bulliqi për vijën kufitare me Malin e Zi. Praktikisht e ka heshtur këtë çështje dhe nuk po lëviz asgjë në atë drejtim. Koordinatat, sipas të cilave duhet të korrigjohet vija kufitare, janë në raportin zyrtar, por as nuk po përmenden nga kryeministri, as nuk po i parashtrohen Malit të Zi. Të gjithë e mbajmë mend se jo pak deputetë u patën mashtruar pikërisht nga premtimi për korrigjimin që nuk po ndodhë", ka thënë Kurti.

Ai ka folur edhe për fazën finale të dialogut me Serbinë. Kurti ka thënë se për BE-në duket se raporti midis Kosovës dhe Serbisë është disi edhe më i rëndësishëm se vetë Kosova. "Në këtë kontekst, qëllimet e Beogradit janë të qarta dhe mund të themi se dy janë kryesore: 1) 'Zajednica' e Serbisë në Kosovë; 2) Anëtarësim sa më i shpejtë i Serbisë në BE. Në përputhje me këto qëllime, presidenti i Serbisë, Vuçiq, shtron kërkesa. Ndërkaq, Kosova nuk i ka formuluar as qëllimet dhe as parimet e vet dhe rrjedhimisht as kërkesat ndaj Serbisë. Krerët e institucioneve nuk e thonë as që synojmë dhe as që e kërkojmë njohjen e pavarësisë dhe dëmshpërblimin nga Serbia. Presidenti aktual flet për 'kompromis të dhimbshëm' dhe duket se e ka fjalën për dhimbjen që do ta ketë Kosova si shtet dhe populli ynë dhe jo vetë ai", ka thënë Kurti, duke shtuar se ky proces i nevojitet Serbisë dhe jo Kosovës. "Qartazi, Thaçi nuk është duke shkuar në Bruksel. Vuçiqi po shkon në Bruksel, kurse Thaçi po shkon te Vuçiq, sepse ky dialog i nevojitet Serbisë për ta përshpejtuar anëtarësimin e saj në BE, kurse Thaçit i nevojitet për ta ngadalësuar përndjekjen nga Gjykata Speciale", është shprehur Kurti.

Ai ka bërë me dije se ky proces është prioritet për Serbinë që të avancojë në negociatat për anëtarësim në BE dhe për presidentin Thaçi. Ky i fundit, sipas Kurtit, është duke e përdorur dialogun me Serbinë si imunitet për vete nga Gjykata Speciale. "Kurrfarë finale e madhe nuk është ky dialog. Serbisë i nevojitet një marrëveshje me Kosovën për ta përmbushur sidomos kapitullin 35 në negociatat për anëtarësim në BE. Presidenti Thaçi nuk mendoj se dëshiron ta përfundojë asnjëherë dialogun me Serbinë për shkak se dëshiron ta fillojë atë pa afate. E këtë e bën meqenëse jeta politike dhe posti zyrtar dhe liria personale i varen nga ai dialog. Duhet të rrojë dialogu me Serbinë që të rrojë Thaçi", ka thënë Kurti.

Lideri i LV-së ka deklaruar se dialogu për normalizim nuk e ka arritur as normalizimin e dialogut. "Konsiderojmë se është i domosdoshëm të bëhet vlerësimi zyrtar i dialogut me një raport qeveritar për vitet e humbura 2011-2017, të raportohet në Kuvend dhe të kemi debat parlamentar. 33 marrëveshje i kanë nënshkruar Kosova me Serbinë në dialogun gjashtëvjeçar. Nuk mund të këtë dialog që na i merr gjashtë vjet pa pasur së paku edhe një vlerësim që na i merr gjashtë javë. Nuk ka demokraci pa llogaridhënie dhe nuk ka llogaridhënie pa vlerësim, pa bilanc. Rezultati kryesor i dialogut për normalizim të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, mund të themi se ishte vetëm Lista Serbe", ka shtuar Kurti.

Kryetari i LV-së ka vlerësuar se presidenti i vendit nuk është as kredibil e as kompetent për këtë proces. "Thaçi është president për vete, jo për Kosovën. Marrëveshjet e presidentit apo ujditë e fshehta të tij nuk do të vlejnë në Kosovë. Kot e ka. Se kush do të jetë udhëheqës i dialogut është shumë e rëndësishme, por ajo është një çështje që vjen në fund, kurrsesi në fillim. Nuk ka shtetndërtim me emra të përveçëm në fillim", ka thënë Kurti, duke shtuar se Kosova fillimisht duhet t'i përcaktojë kërkesat që ka në raport me këtë proces.



# Veseli: Marrëveshja me Serbinë nuk do të jetë kompromis i ri

**Prishtinë, 21 qershor** - Marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk nënkupton asnjë kompromis që e paralizon shtetin e Kosovës dhe nuk nënkupton asnjë lloj ndarje. Kështu ka deklaruar kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". Veseli është shprehur optimist se në fund të këtij viti Bashkimi Evropian dhe vendet anëtare do të vendosin që t'u heqin vizat qytetarëve të Kosovës në mënyrë që edhe ata të lëvizin lirshëm sikurse qytetarët e tjerë evropianë.

Flet për "Epokën e re", Agon Maliqi

# Opozita nuk duhet të trego



Analisti politik Agon Maliqi ka thënë se politikës shqiptare i mungon mendësia shtetformuese, prandaj partitë politikë janë larg arritjes së konsensusit për çështje të interesit kombëtar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se çdo gjë shihet nga prizmi i kalkulimeve politike dhe inateve. Maliqi ka thënë se opozita nuk duhet të tregohet refuzuese dhe inatçore karshi dialogut me Serbinë. Në këtë drejtim, sipas tij, si pikënisje duhet të jetë një platformë e përbashkët me vija të kuqe dhe konsensusi në grupin e unitetit dhe pastaj nuk ka rëndësi se kush u prinë bisedimeve. Maliqi ka vlerësuar se Kosova nuk ka qeveri dhe lidership me kapacitet shtetformues dhe me agjendë të qartë zhvillimore. Ai ka thënë se sundon njëfarë mendësie zhvatëse dhe provinciale

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 21 QERSHOR - **"Epoka e re"**: *Z. Maliqi, të dielën do të mbahet takimi i radhës në nivel të presidentëve në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi, takim ky që nis fazën finale të bisedimeve. Cilat janë pritjet e juaja nga ky proces?*

**Maliqi:** Pritjet nuk janë të mëdha për këtë takim specifik. Dialogu efektivisht është i bllokuar dhe është e qartë se nuk ka kuptim të vazhdojë kështu me formatin e marrëveshjeve të pjesshme mbi problematika të veçanta e që shpesh nuk respektohen. Ajo që ndoshta mund të pritet është ndonjë diskutim në vija të trasha mbi atë se cila është rrugëdalja. Gjegjësisht, se a mund të flasim për fillimin e një procesi të ri drejt asaj që BE-ja po e quan 'marrëveshje përfundimtare dhe ligjërisht detyruese', pra një marrëveshje ku trajtohen të gjitha problematikat bashkërisht, përfshirë edhe zhbllokimin ndërkombëtar të Kosovës, dhe se si mund të strukturohet ky proces negociatash në muajt në vijim. Mogherini me gjasë po përpiqet që dialogut t'ia japë një shtytje të fundit dhe një dinamikë të re sepse asaj dhe Komisionit Evropian u skadon mandati në vitin 2019. Por edhe për shkak se pas miratimit të strategjisë së zgjerimit dhe marrëveshjes historike mes Maqedonisë dhe Greqisë, ekziston një momentum i ri në Komisionin Evropian dhe në shtetet e Kuintit për t'i përmbyllur kontestet bilaterale në Ballkan, që shihen si burim brishtësie, si bllokuese të zgjerimit dhe krijuese të hapësirës për ndërhyrje destabilizuese të vendeve si Rusia.

**"Epoka e re":** *Presidenti Thaçi u bëri ftesë partive politike për përfshirje në negociata dhe krijimin e një ekipi të unitetit? Duhet të përfshihet opozita në këtë proces?*

**Maliqi:** Presidenti duket sikur më shumë po përpiqet t'i bindë të tjerët që t'ia japin atij mandatin për të negociuar sesa për të ndërtuar një frymë konsensuale dhe mirëbesimi për negociata. Në këtë përpjekje tani po e paguan faturën e karrierës politike të bazuar në manovra makiaveliste që e kanë bërë njeri të cilit

# het refuzuese dhe inatçore



pakkush i beson. Sidoqoftë, nuk e kuptoj insistimin e opozitës për t'u përgjigjur me të njëjtën monedhë papërgjegjësie dhe kthimit të kësaj çështjeje të interesit kombëtar në debat të reduktuar në atë se kush duhet t'u prijë negociatave dhe kush nuk bën. Le të jetë pikënisje një platformë e përbashkët me vija të kuqe dhe konsensusi në grupin e unitetit dhe pastaj nuk ka rëndësi se kush u prinë bisedimeve. Ashtu-kështu çdo marrëveshje do të duhet të kalojë në Kuvend dhe nuk është se Thaçi, sidomos pas përvojës me demarkacionin dhe asociacionin, do të mund të nënshkruajë çka do. Në një çështje me interes kaq madhor dhe në një moment kaq delikat gjeopolitik në rajon shqetësimi ynë kryesor nuk mund të jetë nëse dikush po legjitimohet politikisht ose jo.

**"Epoka e re":** *Megjithatë, palët ende janë larg arritjes së konsensusit për dialogun.*

**Maliqi:** Janë larg sepse politikës shqiptare prej vitesh i mungon mendësia shtetformuese. Çdo gjë, edhe çështjet më strategjike, shihen nga prizmi i kalkulimeve politike dhe inateve. Në Shqipëri kjo mungesë konsensusi prej vitesh e ka vonuar forcimin e institucioneve dhe integrimet evropiane, ndërsa në rastin tonë po e mban peng dhe po e dobëson edhe pozicionin tonë negocues me Serbinë. Megjithatë, në këtë ambient cinik politik ekzistojnë edhe rrugëdalje ku gjithkush mund të dalë nga pak fitues. Në një postim në media propozova që opozita në vend se të jetë thjesht retorikisht refuzuese dhe inatçore, mund të tregohet edhe pak kreative dhe produktive në kushtëzimet e saj, në stilin e manovrave të Thaçit. Për shembull, duke e kushtëzuar pjesëmarrjen në dialog me një amendament kushtetues i cili nuk do t'u lejonte presidentëve që pas skadimit të mandatit t'i rikthehen për 5-10 vjet politikës aktive (në ekzekutiv dhe legjislativ). Kështu opozita do të mund të tregohej edhe shtetformuse si konstruktive në dialog, edhe demokratizuese duke e parandaluar instalimin e një modeli politik Gjukanoviq në Kosovë.

**"Epoka e re":** *Është paralajmëruar se në fund të këtij dialogu palët do të arrijnë një marrëveshje përfundimtare ligjërisht të obligueshme. Do të jetë në favor të Kosovës një marrëveshje e tillë apo ka rrezik për kompromise të reja në dëm të shqiptarëve?*

**Maliqi:** Nuk mund të paragjykohet. E kam një përshtypje se te ne dominon njëfarë pasigurie e thellë kolektive dhe bindje joracionale se neve gjithmonë na ngulet. Traumë e popujve të vegjël dhe të kolonizuar që e shohin botën e jashtme si kërcënim. Harrojmë se nga proceset negociuese e kemi sjellë intervenimin e NATO-s dhe shpalljen e pavarësisë. Të ulemi në tavolinë pa ndonjë detyrim për të nënshkruar diçka që na paralizon më shumë se ç'jemi të paralizuar. E mira është se Vuçiqi duket i interesuar të arrijë marrëveshje sepse është në kulmin e fuqisë së tij politike dhe pa kundërshtarë seriozë (më vonë mund ta ketë shumë më vështirë arritjen e marrëveshjes) dhe Kosova falë aleatëve tanë është pengesë e patejkalueshme për rrugëtimin në BE. Ajo që duhet të na japë pak kurajë është se pakkush, përveç Serbisë dhe Rusisë, ka interes ta mbajë Kosovën peng përmes një bosnjëzimi. Nëse i përcillni me vëmendje zhvillimet në Serbi dhe diskursin e Vuçiqit dhe medieve që ai i kontrollon (e ai i kontrollon të gjitha!), Vuçiqi nuk duket shumë i lumtur me atë se çka mund të përfitojë nga negociatat dhe po e përgatit terrenin për dy skenarë. Po flet për presion të hatashëm ndërkombëtar në mënyrë që eventualisht të mund ta arsyetojë tërheqjen prej negociatave. Por edhe për skenarë të Prishtinës për ndërhyrje me dhunë në veri, përmes të cilit, ashtu siç pretendon opozitari Vuk Jeremiq, Vuçiqi me gjasë po e përgatit opinionin edhe për ndonjë kompromis të dhimbshëm të cilin do ta shiste si mënyrë e vetme për t'i shpëtuar serbët nga dhuna (mos të harrojmë, serbët e kanë gjallë traumën e refugjatëve të Kosovës dhe Kroacisë që u zhvendosën pas qasjes kokëfortë të regjimit). Prandaj, nëse vija e mesme apo kompromisi i mbështetur nga Perëndimi është një variant që nuk e kthen Asociacionin në një monstër dhe ia hap Kosovës perspektivën ndërkombëtare, atëherë nuk kemi pse të frikësohemi prej negociatave. Nëse dështojnë, le të jetë Serbia fajtore për këtë dështim.

**"Epoka e re":** *Partitë politike po vazhdojnë mbajtjen e tryezave, por po shihet se nuk ka ende përafrim të qëndrimeve për një temë të caktuar. LDK-ja insiston në zgjedhje të reja, për çka edhe po kërkon konsensus. Si i shihni këto tryeza politike?*

**Maliqi:** Vështirë të komentohet se çfarë po bën opozita kur edhe vetë opozita nuk e di se çfarë po bën. LDK-ja dhe VV-ja janë më shumë të shqetësuara me telashet e brendshme dhe, duke mos qenë gati për zgjedhje, po merren me retorikë opozitare, por jo edhe me aksion opozitar. Dritarja që ekziston për përmbylljen e këtyre negociatave është e ngushtë (1 vit) dhe skenari i zgjedhjeve nuk është i përshtatshëm as për bashkësinë ndërkombëtare. Zgjerimi apo ndryshimi i koalicionit qeverisës me përfshirjen e LDK-së është vështirë i imagjinueshëm. Në këto rrethana, i takon opozitës të jetë konstruktive dhe të gjejë zgjedhje kreative për të mos ia bllokuar Kosovës proceset strategjike. Jam i bindur se kjo do t'i vlerësohet edhe elektoralisht.

**"Epoka e re":** *Z. Maliqi, çfarë vlerësimi keni për qeverisjen aktuale në Kosovë, cilat janë masat urgjente që duhet të ndërmerren në rrafshin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar?*

**Maliqi:** Nuk kemi qeveri dhe lidership me kapacitet shtetformues dhe me agjendë të qartë zhvillimore. Sundon njëfarë mendësie zhvatëse dhe provinciale e preokupuar vetëm për akomodimin e interesave të ngushta. Qeveriset me inercion, pa vizion strategjik të ndërtuar mbi prioritete, sot për nesër, dhe pa skrupull e kujdes për financat publike. Ky koalicion i ndërtuar brenda natës e di se me po aq shpejtësi mund të largohet kështu që problemet dhe punët e vërteta po ua lë atyre që do të vijnë më vonë. Shteti po trajtohet sikur të ishte pazar i kerreve. Nga ky kryeministër që duket se nuk kupton gjë nga qeverisja dhe prioritetet zhvillimore edhe nuk mund të pritej më mirë. Dobësia jonë e brendshme është pastaj edhe e jashtme, duke qenë se nuk po arrijmë të dëshmohemi si storie suksesi. Jemi treguar shtet krejt joserioz në përpjekjet për t'iu shmangur detyrimeve ndërkombëtare që i kemi marrë vetë qoftë me demarkacionin, qoftë me përpjekjen për anulimin e Gjykatës Speciale. Me fjalë të tjera, nga jashtë shpesh dukemi mjaft qesharakë, që është gjëja e fundit që i nevojitet një vendi të cilit shtetësia i kontestohet.

# Hellmichi: Kosova mund të llogaritë në mbështetjen e Gjermanisë

EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, ka pritur të enjten në ministri një delegacion të deputetëve të Kuvendit të Republikës Federale të Gjermanisë, anëtarë të Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes, në krye me Wolfgang Hellmich.

Në takimin e përbashkët të dy delegacioneve, të kryesuara nga ministri Berisha dhe Hellmich, u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërshtetërore Kosovë - Gjermani, në shumë fusha e me theks të veçantë në fushën e sigurisë.

Ministri Berisha e ka falënderuar shtetin dhe popullin gjerman për mbështetjen e pakursyer që kanë dhënë dhe po japin për Kosovën, në ndërtimin, avancimin e institucioneve, me theks të veçantë në fushën e sigurisë si dhe profesionalizimin dhe avancimin e FSK-së.

Ministri Berisha ka potencuar rolin mjaft të rëndësishëm të Gjermanisë në shkollimin, trajnimin dhe pajisjen e FSK-së, si dhe në përgjithësi rolin mjaft aktiv të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Gjermanisë si një partner strategjik dhe i fokusuar në situatën në Kosovë, që nga viti 1999 e deri më tani.

Ministri Berisha i ka njoftuar deputetët gjermanë për misionin, detyrat, të arriturat, sfidat si dhe objektivat për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së në të ardhmen, duke përmendur trajnimet dhe shkollimet si brenda ashtu edhe jashtë vendit të pjesëtarëve të FSK-së, pjesëmarrjen në stërvitje të përbashkëta me partnerët tanë, integrimin e komuniteteve joshumicë dhe të gjinisë femërore, si dhe mbi objektivat e FSK-së për të ardhmen, për arritjen e të cilave rol të rëndësishëm pa dyshim luan edhe shteti i Gjermanisë.

Gjithashtu, edhe zëvendësministri i parë i MFSK-së, Burim Ramadani, para deputetëve gjermanë ka prezantuar planet dhe objektivat për një Kosovë të sigurt si dhe shpalosi faktet dhe rrugën lidhur me përpjekjet politike për gjithëpërfshirje.

Nga ana e tij, kryetari i Komitetit të Mbrojtjes pranë Bundestagut Gjerman, Wolfgang Hellmich, ka theksuar se Gjermania do ta mbështesë Kosovën edhe më tutje. "Ju mund të llogarisni në mbështetjen tonë edhe më tutje", është shprehur Hellmich.



# Lansohet platforma dhe aplikacioni 'Dhuro gjak'



PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Të enjten janë lansuar platforma dhe aplikacioni "Dhuro gjak", që është realizuar si bashkëpunim midis Ministrisë së Shëndetësisë, UNICEF-it përmes "Innovation Lab Kosova" dhe Institutit Riinvest.

Ai ka thënë se Ministria e Shëndetësisë përmes përdorimit të metodave inovative dhe gërshetimit të teknologjisë do t'u japë zgjidhje më praktike shumë problemeve të shtresuara me vite.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë sot se krijimi i platformës online dhe aplikacionit për dhurimin vullnetar të gjakut do t'i rrisë mundësitë e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut për t'u dhënë përgjigje kërkesave të vazhdueshme për gjak për personat në nevojë.

Ushtruesja e detyrës së drejtoreshës së Transfuzionit të Gjakut, Bukurie Zhubi, ka bërë me dije se ky aplikacion do të jetë ndihmë për Qendrën Kombëtare të Tranfuzionit të Gjakut. Ajo shpreson se ky aplikacion të ndikojë në rritjen e numrit të vullnetarëve që dhurojnë gjak në Kosovë. Ajo bëri të ditur se gjatë Javës së Dhurimit Vullnetar të Gjakut që do të përmbyllet të premten, ka pasur rreth 1 000 dhurues vullnetarë të gjakut.

"Dhuro gjak", është një platformë online, e cila ka për qëllim sensibilizimin dhe njoftimin e qytetarëve për rëndësinë e dhurimit të gjakut, duke përdorur një aplikacion online, i cili ndihmon Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut ta rrisë numrin e dhuruesve.

## Thaçi merr mirënjohje nga përfaqësuesit e komunitetit egjiptian në Kosovë

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, për nder të "Javës Egjiptiane" dhe 24 Qershorit, Ditës Memoriale të Komunitetit Egjiptian në Kosovë, ka pritur të enjten një delegacion të këtij komuniteti, të udhëhequr nga deputeti i Kuvendit të Kosovës, Veton Berisha, njëherësh kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane.

Pjesë e delegacionit të komunitetit egjiptian ishin edhe dr. Zahi Hawass, ish-ministër dhe arkeolog nga Egjipti, si dhe Noureldin Eltamimy, përgjegjës për dosjen e egjiptianëve. Presidenti Thaçi theksoi se komunitetet e Kosovës janë vlerë për Kosovën dhe përsëriti përkushtimin e institucioneve të shtetit të Kosovës për t'i akomoduar të gjitha komunitetet në Kosovë.

Ndërsa anëtarët e këtij delegacioni nga Egjipti, presidenti Thaçi i falënderoi për njohjen e Kosovës dhe mbështetjen e shtetit tonë. "Egjipti është shtet mik i yni dhe jemi mirënjohës për përkrahjen që na keni dhënë", u shpreh presidenti Thaçi.

Duke falënderuar presidentin Thaçi për përkrahjen për komunitetin egjiptian në Kosovë, deputeti Berisha i dhuroi në emër të komunitetit edhe një mirënjohje për kontributin e tij. "Të falënderoj për çdo gjë që ke bërë për komunitetin tonë", u shpreh deputeti Berisha.

Pjesë e delegacionit ishin edhe aktivistja Mirlinda Hoti, këshilltari i kryeministrit të Kosovës, Isa Osmani, zëvendësministri i MAPL-së, Bashkim Krasniqi, zëvendësministri i MASHT-it, Artan Berisha dhe Shemsi Kopliku, aktivist nga diaspora.



# Kalueshmëria e testit të maturës, 73.3 për qind

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Komisioni Shtetëror i Maturës (KShM) ka mbajtur të enjten konferencë për media, ku është bërë publikimi i rezultateve të Maturës Shtetërore 2018, sipas të cilave, këtë vit kalueshmëria ka arritur shifrën 73.3 për qind. Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, me këtë rast u ka uruar sukses të gjithë maturantëve në regjistrimin e tyre, në drejtimet të cilat ata janë përcaktuar, ndërsa ka theksuar se këtë vit është shënuar sukses sa i përket mbarëvajtjes së testit dhe nxjerrjes së rezultateve reale. "Nga rezultatet të cilat i kemi, kalueshmëria në pjesën e parë të testit të maturës 2018 është 73.3 për qind. Kemi një shkallë më të lartë të arritshmërisë te pjesa e testit në gjuhën shqipe. Në gjuhën boshnjake kalueshmëria është 88.7 për qind, ndërsa në gjuhën turke 56.6 për qind", ka thënë Bytyqi.
Ministri Bytyqi, pasi ka falënderuar Komisionin Shtetëror të Maturës, DKA-të, drejtorët e shkollave, komisionarët, administratorët dhe të gjithë të tjerët të cilët kanë kontribuuar në procesin e mbarëvajtjes së tetit, ka theksuar se testi i maturës 2018 ka arritur të dalë me rezultate reale dhe këto të dhëna të shërbejnë për marrjen e hapave të nevojshëm për ngritjen e cilësisë.
Ministri Bytyqi ka thënë se është shënuar sukses në mbarëvajtjen e testit përkundër tentimeve për ta prishur imazhin e Testit të Maturës, ndërsa ka bërë me dije se KShM-ja javën e ardhshme do të mblidhet dhe do ta caktojë datën se kur do të mbahet pjesa e dytë e testit.
Nga procesi i testit të maturës 2018, për shkak të shkeljeve që




janë shënuar, është anuluar testi për 87 nxënës, ndërsa për shkak të shkeljeve të vendimeve të MAShT-it, nga procesi i administrimit janë larguar tetë administratorë. Këtë vit maturantët do të pajisen me certifikatë të re, e cila do të jepet falas nga Ministria e Arsimit.

# Filluan punën 18 specialistë të ri në spitalet e përgjithshme



Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Nga dita e enjte spitalet e përgjithshme do të kenë më shumë mjekë specialistë që do të ofrojnë shërbime shëndetësore për qytetarët. Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), dr. Basri Sejdiu, ka nënshkruar kontratat e punës për 18 specialistë të profileve të ndryshme të cilët do të punojnë në kuadër të spitaleve të përgjithshme, të pranuar në kuadër të konkursit të fundit të shpallur nga ShSKUK-ja.
Në këtë konkurs janë pranuar katër specialistë për Spitalin e Prizrenit, dy për Spitalin e Pejës, një në Gjakovë, tre në Gjilan, tre në Ferizaj, tre në Mitrovicë dhe dy në Spitalin e Vushtrrisë.
Në prioritetet e menaxhmentit të ShSKUK-së është përforcimi me kuadro mjekësore i spitaleve të përgjithshme në mënyrë që pacientët të marrin shërbime shëndetësore në rajonin ku banojnë dhe mos të kenë nevojë të drejtohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.
ShSKUK-ja do të hapë së shpejti konkurse të tjera për pranim të stafit në spitalet e përgjithshme, në mënyrë që të zëvendësohen kuadrot që kanë dalë në pension, por do të ketë edhe pranime të reja.

# Meteorologu Aliu: Vera, me temperatura normale

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Meteorologu Besim Aliu nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka bërë me dije se në këtë verë temperatura më e lartë pritet të shënojë 39 gradë celsius. Ai ka theksuar se nuk do të ketë temperatura më të larta nga ato që janë shënuar vitet që kemi lënë pas. Në një bisedë për "Radion Vala Rinore" ai ka thënë se ndryshe nga vitet që lamë pas, këtë vit ka pasur verë të hershme, pasi gjatë muajit prill termometri ka shënuar 28 deri 30 gradë celsius, ndërsa ka pasur luhatje të motit me reshje të mëdha të shiut dhe breshrit dhe janë dëmtuar zonat bujqësore.
I pyetur nëse do të mund të ketë krizë për ujë për shkak të temperaturave të larta që mund të arrijnë, Aliu ka thënë se kjo është tejkaluar pasi ka pasur shumë reshje gjatë dy muajve të fundit por, siç ka thënë ai, ajo së cilës i druhemi më së shumti është breshri. Sipas tij, breshëri mund të jetë i paparashikueshëm dhe të bjerë deri në muajin gusht. Kurse sa i përket gjendjes së ajrit gjatë kësaj stine, duket se nuk do të kemi probleme pasi, sipas Aliut, ajri paraqet problem më shumë gjatë dimrit, kur shtypja atmosferike është e lartë dhe nuk kemi rrymim të ajrit, ku të gjitha ndotjet që shkaktohen në tokë rikthehen përsëri aty.



# Tatimpaguesit të kënaqur me shërbimet e ofruara nga ATK-ja

Prishtinë, 21 qershor (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH ka mbajtur të enjten një konferencë të përbashkët për medie, në të cilën janë prezantuar rezultatet e anketës me tatimpagues për vitin 2017 lidhur me perceptimet e tatimpaguesve, përfshirë individët dhe bizneset e madhësive dhe sektorëve të ndryshëm, lidhur me punën dhe shërbimet e ofruara nga ATK-ja.

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i opinionit të tatimpaguesve mbi mandatin e ATK-së, disponueshmërinë e informatave nga ATK-ja, vështirësitë dhe koha që shpenzohet për procedurat e ATK-së, profesionalizmi dhe trajtimi që ata marrin nga stafi i ATK-së.

Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se ka rritje të kënaqshmërisë së tatimpaguesve për shërbimet e ATK-së gjatë vitit 2017. "Në të gjitha fushat ka rritje të kënaqshmërisë së tatimpaguesve ndaj ATK-së", ka thënë drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Sakip Imeri. Ai ka treguar se kjo është anketa e dytë e këtij lloji dhe ka për qëllim t'i identifikojë dobësitë e ATK-së si dhe t'i identifikojë rastet kur tatimpaguesit konsiderojnë dhe vlerësojnë veprimet e ATK-së si të pamjaftueshme në ofrimin e shërbimeve për ta. "Bazuar në të gjeturat e kësaj ankete do t'i orientojmë aktivitetet tona, në mënyrë që tatimpaguesit t'i realizojnë të drejtat e tyre që i takojnë me ligj, dhe nuk do të lejojmë që ato të drejta të cenohen në çfarëdo forme", ka thënë Imeri.




# Lekaj e Markusz bisedojnë për projektet infrastrukturore



Prishtinë, 21 qershor (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Hungarisë në Kosovë, Laszlo Markusz, me të cilin ka biseduar për rrjedhën e progresit të projekteve infrastrukturore, me theks të veçantë për Autostradën R6 "Arbën Xhaferi", Prishtinë - Hani i Elezit, autoudhën Kijevë - Zahaq, modernizimin e hekurudhave në nivel vendi dhe hapësirën e lartë ajrore të Kosovës.

Interesimit të ambasadorit hungarez Laszlo Markusz, lidhur me taksën rrugore për mirëmbajtjen e autoudhëve në vend, ministri Lekaj iu përgjigj se një gjë e tillë do të ndodhë në të ardhmen e afërt, por që do të bëhet në konsultim të gjerë të publikut dhe me një kosto që do të jetë e përballueshme për ekonominë e qytetarëve. Ministri Lekaj e ka informuar ambasadorin hungarez edhe për angazhimin që të krijohen kushtet e duhura për transportuesit përgjatë autostradave. Ndërkaq ambasadori Laszlo Markusz ka bërë me dije se shteti i tij nëpërmjet sistemit të ITS-it ka arritur që të vë tarifën më të ulët për rrugët. Ministri Lekaj ka thënë se kjo është një mundësi e mirë edhe për Kosovën.

# Limaj: Ndihma e FMN-së është e rëndësishme për Kosovën

Prishtinë, 21 qershor- Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka pritur të enjten në takim shefin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën, Ruud Vermeulen. Në këtë takim, sipas Limajt, është diskutuar për pagën minimale, çështjen e veteranëve të luftës, reformimin e sistemit pensional dhe njohjen e statusit për mësimdhënësit e viteve '90-ta. "Pata kënaqësinë ta prisja në takim shefin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën, z. Ruud Vermeulen. Paga minimale, çështja e veteranëve të luftës, reformimi i sistemit pensional dhe njohja e statusit për mësimdhënësit e viteve të '90-ta, ishin disa nga temat që i trajtuam me z. Vermeulen. Ndihma dhe këshillat profesionale të kësaj zyre janë shumë të rëndësishme për Qeverinë e Kosovës në hartimin e politikave sa më të mira fiskale për këto dhe shumë çështje të tjera", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".



# Apostolova kërkon tërheqjen e vendimit për rritjen e pagave për qeveritarët



Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, Nataliya Apostolova, në një deklaratë për media ka theksuar se vendimi i Qeverisë së Kosovës për rritje të pagave duhet të tërhiqet dhe të pritet miratimi i ligjit të ri për pagat. Ndërkaq shefi i kabinetit të kryeministrit, Avni Arifi, ka reaguar ndaj deklaratës së Apostolovës lidhur me vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave për vetveten. Ai ka theksuar se vendimi i Qeverisë së Kosovës për ngritjen e pagave është legal, legjitim dhe kushtetues

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Prishtinë, Nataliya Apostolova, në një deklaratë për media ka thënë se vendimi për rritjen e pagave të kabinetit qeveritar në Kosovë duhet të tërhiqet dhe të pritet miratimi i ligjit të ri për pagat. Ajo ka theksuar se ky vendim është në kundërshtim me qëllimet e përbashkëta për ta bërë administratën publike të Kosovës më të barabartë, meritore, koherente dhe llogaridhënëse. "Më 12 qershor Qeveria riktheu vendimin e saj për rritje ad hoc të pagave për anëtarët e kabinetit, këshilltarë të caktuar, disa nënpunës të lartë civilë dhe stafin mbështetës të kabinetit qeveritar. Shpreh keqardhjen time për këtë vendim, pasi që përgatitja e Projektligjit për Pagat është në proces e sipër. Ky ligj do të rregullojë njëherë e përgjithmonë pagat që paguhen nga buxheti i Kosovës me kritere objektive dhe të drejta. Ky ligj është pjesë e procesit të reformave në administratën publike e të cilin BE-ja e mbështet", ka thënë Apostolova. Kurse ndaj deklaratës së shefes së BE-së, Nataliya Apostolova, ka reaguar shefi i kabinetit të kryeministrit Avni Arifi. Ai ka thënë se vendimi i Qeverisë së Kosovës për ngritjen e pagave është vendim legal, legjitim dhe kushtetues. "BE-ja do të ishte mirë që në vend të sfidimit të vendimeve të tilla nga fusha e përgjegjësive qeverisëse, ta sigurojë implementimin e marrëveshjeve që vetë i ka garantuar, siç është marrëveshja për energjinë. Nëse sipas ekspertëve, Kosova në vit i humbet 25 milionë euro si pasojë e moszbatimit të marrëveshjes për energjinë, atëherë që nga viti 2013 Kosova i ka humbur 150 milionë euro. Zyra e BE-së në Kosovë, sot, duke komentuar pagat e zyrtarëve qeveritarë, e pati gabim. Kosova ndihmohet duke implementuar marrëveshjen e garantuar për energjinë dhe jo duke dhënë vlerësime për vendime legjitime politike gati si parti politike që synon sukses elektoral zgjedhor", ka shkruar Arifi në llogarinë e vet në "Facebook".

Në lidhje me vendimin për rritje të pagave për qeveritarët pati dhënë një opinion edhe Agjencia Antikorrupsion në Kosovë, e cila e vlerësoi të jashtëligjshëm vendimin për rritje të pagave nga ana e kabinetit qeveritar.

Sipas opinionit të AKK-së, zyrtarët e lartë publikë (kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat dhe zëvendësministrat) që kanë votuar këtë vendim "kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konkretisht me konfliktin e interesit 'rast për rast', dispozitat e caktuara që rregullojnë 'Veprimet e ndaluara për zyrtarin e lartë', si dhe me shumicën e dispozitave që përcaktojnë 'Parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit të lartë publik".

AKK-ja ka konstatuar se konflikti i interesit është shkaktuar vetëm për zyrtarët e lartë që kanë qenë pjesë e procesit të vendimmarrjes. "Vendimi i Qeverisë i datës 20. 12. 2017 nuk mund të cilësohet si konflikt interesi për të gjithë ata të cilët janë përfitues nga nxjerrja e këtij vendimi. Konflikti i interesit është paraqitur tek zyrtarët e lartë të cilët me votën e tyre kanë ndikuar që vendimi të jetë në interes të tyre për përfitime personale", është theksuar në opinionin e AKK-së.

Edhe shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka reaguar për rritjen e pagave të qeveritarëve. Ai ka theksuar se rritja e pagave të kabinetit qeveritar është vendim arbitrar dhe përbën shkelje të ligjeve në fuqi, si dhe paraqet konflikt të interesit. "Rritja e pagave duhet të bëhet vetëm me ligj, jo me vendim arbitrar të Qeverisë që përbën shkelje të ligjeve në fuqi dhe paraqet konflikt të interesit. 1. Rritja e pagave është e rregulluar me Ligjin për financat publike, ku caktohet si dhe sa rriten çdo vit. Çdo qasje tjetër është shkelje e këtij ligji. 2. Ky vendim bie ndesh me Ligjin e buxhetit për vitin 2018. Është vetëm Kuvendi i Kosovës ai që ka autoritetin ta ndajë buxhetin për destinime të caktuara. Përtej këtyre ndarjeve, çdo alokim tjetër është brenda limiteve të caktuara në Ligjin e buxhetit dhe Ligjin për financat publike. 3. Ky vendim bie ndesh me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, siç e ka përcaktuar në vendimin e vet Agjencia Antikorrupsion, që është e thirrur ta interpretojë Ligjin për konfliktin e interesit. Nuk mund dikush të marrë një vendim që e prek atë dhe vetëm personalisht si dhe njerëzit e afërm me të", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Në dhjetor të vitit të kaluar, Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga Ramush Haradinaj, mori vendim t'ia rrisë pagat kabinetit qeveritar. Vendimi u pezullua për disa muaj, derisa Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi më 11 qershor se ai nuk është jokushtetues. Sipas këtij vendimi, paga e kryeministrit nga 1 500 euro sa ka qenë, do të bëhet 2 950 euro, kurse e zëvendëskryeministrave nga 1 300 euro, në 2 500 euro. Paga e një ministri ka qenë rreth 1 200 euro ndërkaq, sipas këtij vendimi, do të jetë 2 000 euro. Kurse mbi 70 zëvendësministra, të emëruar në Qeverinë Haradinaj, do të pranojnë pagë mujore nga 1 150 euro.

# 'Hardh Fest' vjen me sloganin e ri




RAHOVEC, 21 QERSHOR (ER) - "Hardh Fest 2018" këtë vit organizohet nën sloganin "Me pamje kah vneshtat", më 7, 8 dhe 9 shtator në Konak të Rahovecit. "Turistët do të kenë mundësi të kënaqen me pamjet që ofron qyteti i Rahovecit bashkë me plantacionet e vreshtave, që ndryshe ky vend cilësohet nga turistët ndërkombëtarë edhe si Toskana e Kosovës. Jeta në Hardh Camp, panairi i verës, garat në shtrydhjen e rrushit, netët me muzikë, plot shoqëri dhe një gotë verë rreth kazanit të rakisë dhe zjarrit, e më pas momentet e këndshme të mëngjesit, janë përvoja e plotë e shpirtit dhe jetës së Hardh Festit", është thënë në njoftimin për medie të "Hardh Festit".
Me sloganin "Me pamje kah vneshtat" festivali "Hardh Fest" këtë vit do të sjellë shumë risi dhe atraksione vreshtare, verëtare, turistike dhe kulturore.
Festivali organizohet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, si dhe me përkrahje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe sponsorëve të festivalit. Festa e vjeljes së rrushit, "Hardh Fest", edicionin e kaluar shënoi sukses të madh, ku numri i pjesëmarrësve arriti mbi 50 mijë vizitorë nga mbarë bota.

# Komuna e Mitrovicës vazhdon mbështetjen e fermerëve



MITROVICË, 21 QERSHOR (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve dhe planeve zhvillimore në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, Komuna e Mitrovicës realizoi projektin "Subvencionimi i fermerëve me koshere bletësh". Në kuadër të këtij projekti kanë përfituar gjithsej 85 fermerë, të cilëve u janë dhuruar nga tre komplete koshere bletësh (9 copa) dhe disa pajisje të tjera shtesë.
Në takimin e mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës, me rastin e nënshkrimit të kontratave nga ana e bletarëve, nënkryetari i komunës, Faruk Mujka dhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (DBZHR), Ekrem Sadiku, informuan fermerët për investimet që komuna ka bërë dhe do të bëjë në të ardhmen në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.
Nënkryetari Faruk Mujka ka theksuar se investimet në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural janë një ndër prioritetet e zhvillimit ekonomik të Komunës së Mitrovicës, andaj edhe komuna vazhdimisht të mbështesë dhe do t'i rrisë investimet në sektorin e bujqësisë, duke i mbështetur fermerët përmes subvencioneve dhe grandeve.
Ndërsa drejtori Sadiku ka falënderuar nënkryetarin e komunës, stafin e drejtorisë dhe fermerët për punën dhe bashkëpunimin në realizimin e këtij projekti. Ai ka thënë se DBZhR-ja në bashkëpunim me donatorë ka realizuar një numër të madh të projekteve në mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural ku janë ndihmuar pothuajse të gjithë sektorët. Po ashtu, Sadiku ka theksuar se DBZhR-ja do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me fermerët, shoqatat e fermerëve, institucionet relevante, organizatat qeveritare dhe joqeveritare për të qenë vazhdimisht në rrjedha dhe në shërbim të fermerëve dhe qytetarëve.




# Të premten mbahet takim i deputetëve me qytetarët e Pejës

PEJË, 21 QERSHOR (ER) - Në vazhdën e aktivitetit "Ditët e Kuvendit" të premten mbahet takimi i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës me qytetarë të Pejës. Takimi mbahet në Teatrin "Istref Begolli" dhe fillon në orën 14:00. Gjatë këtij takimi publik qytetarët e Pejës do të kenë mundësi të diskutojnë me deputetët Besa Gaxherri, Hajdar Beqa, Fatmire Kollçaku, Dukagjin Gorani, Muharrem Nitaj dhe Haxhi Shala.

# Jashari sheh nga afër punimet për rivarrimin e trupave të dëshmorëve

SKENDERAJ, 21 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, është njoftuar nga afër me punimet që janë duke u zhvilluar në rivarrimin e trupave të dëshmorëve nga Polaci në Marinë. Ai ka bërë me dije se zhvarrimi i dëshmorëve të UÇK-së nga varrezat e fshatit Polac të Komunës së Skenderajt, për t'u rivarrosur në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë, ka filluar dhe gjatë këtyre ditëve gjithçka është duke shkuar sipas planit. Jashari ka thënë se ky aksion do të vazhdojë për disa ditë derisa të bëhet rivarrimi i të gjithë dëshmorëve të rënë të UÇK-së, me nderimet më të larta ushtarake dhe shtetërore.



# Policia arreston një person të dyshuar për vjedhje të kuletave



PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Në pikën kufitare në Kullë është arrestuar një person i dyshuar i cili ishte në kërkim të policisë për disa raste të vjedhjeve nga Stacioni Policor Qendra në Prishtinë. "G. LL., mashkull, 43 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nga hetuesit e Stacionit Qendra është identifikuar që nga viti 2017, dyshohet të jetë i përfshirë në disa raste të vjedhjeve që janë raportuar në polici (kryesisht janë vjedhje të kuletave)", është thënë në njoftimin e policisë.
Personi i dyshuar me urdhër të prokurorit të shtetit është dërguar në qendrën e mbajtjes për 48 orë. Ndërsa hetuesit policorë të të gjitha stacioneve të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë janë duke kryer veprimet e nevojshme policore për kompletimin e lëndëve, të cilat pastaj do të procedohen në institucionet përkatëse.

Nuk ka bisedime me Serbinë pa u evituar Kosova nga preambula e kushtetutës serbiane (2)

# E KENI SJELLË KOSOVËN BUZË DËSHTIMIT



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Tani një vullkan fjalësh po shpërndahen në mediume, se negociatat "teknike" duhet t'i vazhdojë presidenti Hashim Thaçi. Bile ky njeri që ka kaluar nga gabimi në huqe, është favorizuar edhe nga Qeveria inflative me zëvendësministra. Ju them, nga njohuritë që i kam, se kjo politikë do ta dërgojë Kosovën në pozicionin e Gjermanisë Lindore. Pazari në horizont është ky, sepse lufta gjeostrategjike e liferimit të kapitalit ka kaluar në meridiane dhe paralele të tjera. Mjerisht, këtë pazar nuk është duke e vërejtur asnjë trust politik në Kosovë. Shikoni vetëm një blefim politik se si Edita e negociatave "teknike" që ia ngjiti Kosovës bishtin (fusnotën kudo), alarmon në gazetë se "negociatat duhet t'i drejtojë Hashim Thaçi". Këtë propozim kjo "gjenerale" pa ushtri e propozon sepse mendon se asgjë nuk do të shpalohet pastaj në huçet e saj. Së dyti, këtë propozim e ka "me vend", sepse është e porositur "made in Bruksel" alias Karla del Ponte dhe Dik Martinoviq. Këtu diku maskohet lepuri dhe tigri në gjungullën politike të Kosovës, ku partitë politike parlamentare, duke e lenë Republikën e Kosovës pa ligje, e kanë kthyer parlamentin në tribuna "shkencore", ku promovohen liderët e mëhallëve, për zgjedhje të reja, por me një droje se këta parlamentar nuk do të rizgjidhen, prandaj zgjedhjet i kërkojnë (nuk) me gjysmë zemre. Kush do të fitojë? Pjesa dërmuese e politikanëve në Kosovë vërehet se ushqehet me vetëkënaqësi feudale. Tani kjo udhëheqësi i ka para veti këto kushte për t'i plotësuar para atyre që i dirigjojnë. Pazari i lakuriqar nga zyra konfidenciale e A. Vuçiqit është kjo, e ju politikanë zieni ve në akull me këshilltarë të lagjes nepotiste gjenetike dhe ideologjike. Dikur do të këndelleni, e di. Por, atëherë do të jetë vonë. Ju them pa ekuivokë. Tani lexoni pozicionet që vet e keni sjellë Kosovën buzë dështimit. E keni harruar gjakun e dëshmorëve, edhe pse po mbani parade "ambientale" zgjedhore për ta.

Lexoni kushtet që duhet t'ia plotësoni Serbisë neofashiste plus BE-së, e ato janë maskuar për popullin nga ju e ku thuhet: 1. Lejohet themelimi i ushtrisë Kosovës (për t'u future ju në lojë); 2. Kosova të pranohet në OKB; 3. Hashim Thaçi nuk do të arrestohet si kërkon Dik Martinoviqi; 4. U lejohen vizat shtetasve të Republikës Kosovës; 5. Nuk e detyrojmë Serbinë që ta njoh Republikën e Kosovës; 6. Parlamenti i Republikës Kosovës duhet ta ndryshojë Kushtetutën e Ahtisarit dhe Lista serbiane të krijojë komunat me kompetenca ekzekutive, ashtu si e krijoi Hollbruku në Bosnje Republikën serbiane; 7. Liqeni artificial i Ujamanit, Trepça, Brezovica, rrjeti elektrik ndërshtetëror, kisha eksterritoriale, janë kushte nga lista esenciale e "medikamenteve" me kusht që lufta speciale mos të bartet në trevën e Serbisë, ku çështja e Sanxhakut Nishit me 714 fshatra dhe 6 qytete të okupuara më 1877/78 të dhuruara Principatës serbiane nga kryqëzata evropiane në Berlin (1878) dhe tradhtia e nënës së Padishahut po edhe vet Padishaut me Ali Pash Maxharrin (1876-1879) mos të përmendën askund si toka shqiptare nga Antika, si Jerusalem i shqiptarësisë moçme.

Këto janë maskat që Serbia i ka siguruar përmes injorancës politike dhe lideriste feudale të Hashim Thaçit, Isa Mustafës, Edita Tahirit dhe kompanisë. Në këtë lagje po aspiron të injektohet mjerisht edhe Ramush Haradinaj, sepse ai nuk pranon asnjë këshillë nga ata që nuk janë "akademik". Si duket Ramushi me shokë aspiron të bëhet akademik dhe i plotëson kushtet sepse nuk kanë vepra shkencore.

Çdo respekt luftës së tij dhe gjakut të UÇK-së, por ku mbeti Adem Demaçi more burra, të cilin qe dy vite nuk e vizitove kurrë. E te varri i atij që t'i ka larguar 11000 armë nga fronti; që ka dërguar ekip "profesional" në Drenicë (shtator 1998) për ta çarmatosur UÇK-në për çdo muaj po i bëni proskineza. Bravo, kështu trashet burrëria me bashkëpunëtorët, madje atij që deri dje të ka sha e pështy, ia uron zgjedhjen dhe i dërgon zëvendëskryeministrin për t'ia uruar në zyre. E tash po të "ndihmojnë" përmes një konfidenti ish-anëtar i lartë i LDK-së i arratisur nga Kosova për shkaqe "partitike-patriotike", për çka ish shefi i vdekur të ka afruar dhe të ka mbajtur në Hagë për katër (4) vite. Dil e t'i masim argumentet. E vërteta, as LDK-ja nuk e ka përdhosur Adem Demaçin dhe ushtarët e tij e të Adem legjendarit, sa kjo garniturë që është sot në pushtet e besa edhe një pjesë në opozitë. Lidhur me parimet që i theksova, sidomos, Hashim Thaçi nëse punon me logjikë politike, nuk duhet ta pranojë patentimin që t'i ridrejtojë bisedimet "teknike", sepse është dëshmuar me Rambujen, me Kumanovën ku nuk u ftua fare, me Vjenë ku i ka mbetur Kosovës thika në shpinë, me Brukselin ku janë bërë pazare meskine që kur të zbulohen arratia nga Kosova, do të jetë çështje minore. Pazaret jopublike me demarkacionin, gabime dhe shkeljet 23 të Kushtetutës me asociacionin serbian, me nënshkrime për rrymën, tagrat, fusnotën, veriun e "integruar" e çka nuk dihet, sepse nuk jam funksionar e t'i theksojë, natyrisht të argumentuara, sepse një ditë do të hapen për publikun ato pesë ambasadat që e sundojnë Kosovën. Atëherë populli do të rebelohet sikurse më 2004, e ajo nuk duhet të ndodhë, sepse atëherë po se po do të implementohen parimet e sipërtheksuara proserbiane, për ta shpëtuar bishtin ata që do të nxinë në 'flagrancë". I këshillojë shqiptarët që mos të bien në grackën e vitit 2004. Grackat në radhë që janë edhe më të rënda, do të dëshmojnë se kush frikësohet nga hijet, do ta hanë hija e vet! Shpifni sëmurje, po bini vet në to.

Nëse më 17 shkurt 2008 Kosova e ka shpallë pavarësinë, atëherë duhet shtrohet pyetja çka aspiron Serbia të shkëputë nga ajo pavarësi. Meqë e di nga burimet primare, por kurrë nuk konsultohem, atëherë duhet të flas tërthorazi sepse kam pasoja personale pastaj ashtu si pata për demarkacionin!! Lidhur me këtë asnjë parti nuk bënë dallime në pazare kur është në pushtet. Më 2004 fjalën kryesore de fakto e kishte kreu i LDK-së, por haraçin e paguan ata të gjakut patriotik. Në vijim asnjë parti-person, nuk duhet ta marrë përsipër drejtimin e negociatave "teknike". Atë detyrë duhet ta marrë Qeveria dhe Parlamenti, ku duhet inkorporohen institucionet shkencore, kulturore dhe arsimore, kuptohet me këshilla ekipore, nëse kanë kuadro. (Fund)

# Komandanti i FSK-së, pjesë e konferencës vjetore të ushtrisë amerikane

Prishtinë, 21 qershor - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, nga data 19 e deri më 21 qershor, ka marrë pjesë në konferencën vjetore të organizuar nga ushtria amerikane për Evropë, që është mbajtur në Garmish të Gjermanisë. Qëllimi i mbajtjes së kësaj konference është thellimi i bashkëpunimit në Programin e Partneritetit Ndërshtetëror.

Bashkëpunimi në mes të Kosovës, përkatësisht FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, është modeli më i mirë që tregon se si në një periudhë të shkurtër mund të arrihet progres në të gjitha nivelet e zhvillimit profesional të një force. Sipas komunikatës së FSK-së, Rama gjatë kësaj konference ka takuar shumë liderë dhe shefa të mbrojtjes të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të vendeve Baltike dhe përfaqësues të EUCOM-it.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajori Timothy Orr, në forumin e Ballkanit Perëndimor kanë diskutuar edhe lidhur me mundësitë dhe planet për të ardhmen në kuadër të zgjerimit dhe thellimit të aktiviteteve, përfshirë qasjen rajonale, ndërtimin e aftësive dhe trajnimet e përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit rajonal.



## Trumpi takon Putinin?

UASHINGTON, 21 QERSHOR - Njoftohet se po zhvillohen përgatitje për një takim mes presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump dhe presidentit të Rusisë, Vladimir Putin. Mediet citojnë dy persona që kanë dijeni mbi çështjen, por që kanë kërkuar të mbeten anonimë. Takimi pritet të zhvillohet gjatë vizitës së Trumpit në Evropë muajin e ardhshëm. Të dy udhëheqësit mund të takohen përpara takimit të NATO-s që mbahet më 11 dhe 12 korrik në Bruksel, ose pas vizitës së presidentit Trump në Britani, dy ditë më vonë.
Të mërkurën Shtëpia e Bardhë nuk pranoi të komentojë lidhur me këtë çështje dhe Këshilli Sigurisë Kombëtare nuk iu përgjigj një kërkese të "Zërit të Amerikës" për komente.
Zëdhënësi i Putinit, Dmitri Peskov, gjithashtu nuk pranoi të komentojë gjatë një konference me gazetarët të enjten, por ai tha se këshilltari amerikan për Sigurinë Kombëtare John Bolton pritet ta vizitojë Rusinë javën e ardhshme për të diskutuar rreth përgatitjeve. Ende nuk dihet se ku do të zhvillohet takimi por, sipas disa medieve të huaja, udhëheqësit mund të takohen në një nga kryeqytetet evropiane, pas samitit të NATO-s. Sipas disa raporteve, Vjena është një vend i mundshëm.
Trumpi ka shprehur interes në rivendosjen e statusit të Putinit në skenën botërore. Më parë gjatë këtij muaji, në takimin e grupit të shtatëshes që u mbajt në Kebek, ai propozoi që Rusia të ripranohet në Grupin e Tetë vendeve më të industrializuara të botës. Anëtarësimi i Rusisë u pezullua pas aneksimit të Krimesë në vitin 2014.



# Stoltenbergu: Lidhja Evropë - ShBA është e fortë

Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se lidhja mes ShBA-së dhe Evropës është e fortë, mirëpo disa janë duke dyshuar në të. Ai ka thënë se mund të kemi parë dobësimin e disa lidhjeve, mirëpo ai ka insistuar se ruajtja e marrëdhënieve transatlantike është në interesin tonë strategjik



LONDËR, 21 QERSHOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se është i bindur se do të mbijetojnë lidhjet mes Evropës dhe Shteteve të Bashkuara, pavarësisht prej dallimeve në tregti dhe vendimit të ShBA-së për t'u larguar nga Marrëveshja e Parisit për Klimën dhe pakti bërthamor me Iranin. "Lidhja jonë është e fortë, mirëpo disa janë duke dyshuar në të. Dhe po, ne po i shohim dallimet", ka thënë Stoltenbergu para audiencës në Londër. "Nuk është e shkruar në gurë se lidhjet transatlantike do të mbijetojnë përgjithmonë, mirëpo besoj se ne do t'i ruajmë ato", ka thënë ai.
Stoltenbergu ka thënë se mund të kemi parë dobësimin e disa lidhjeve, mirëpo ai ka insistuar se ruajtja e marrëdhënieve transatlantike është në interesin tonë strategjik.
Deklaratat e tij kanë ardhur para mbajtjes së samitit të liderëve të NATO-s në Bruksel në muajin korrik.
Presidenti amerikan, Donald Trump, i cili vazhdimisht ka kritikuar aleatët e aleancës për shkak të siç është shprehur ai niveleve të ulëta të financimit në mbrojtje, pritet të marrë pjesë në këtë samit.
Stoltenbergu ka thënë se pret që Trumpi të jetë "shumë i ashpër" sa i përket mbrojtjes në këtë samit.
Shefi i NATO-s ka thënë në fjalimin e tij se është rëndësishme për të përmendur se shtetet evropiane kanë filluar t'i rrisin fondet për mbrojtje. Stoltenbergu ka thënë se bota përballet me "ambientin më të paparashikueshëm në gjeneratë" për shkak të kërcënimit nga terrorizmi, sulmeve kibernetike dhe politikës agresive të Rusisë. "Ne duhet të vazhdojmë t'i mbrojmë institucionet tona siç është NATO-ja dhe duhet të veprojmë në bazë të rregullave ndërkombëtare", ka thënë ai.
Disa zyrtarë evropianë kanë shprehur shqetësimet e tyre se administrata e Trumpit nuk do të jetë mjaftueshëm e ashpër për ta ndëshkuar Moskën për veprimet e saj, duke përfshirë ndërhyrjen në zgjedhje dhe helmimin e ish-spiunit rus, Sergei Skripal, me agjent nervor në Britani.
Trump ka shokuar muajin e kaluar grupin e shtatë shteteve më të industrializuara (G7) gjatë punimeve të një samiti në Kanada, kur ka thënë se Rusisë duhet t'i jepet mundësia për të t'u kthyer në këtë grup.
Moska nuk është pjesë e grupit në fjalë për shkak të aneksimit të Krimesë nga Ukraina më 2014. Disa aleatë janë shprehur të shqetësuar edhe pas raportimeve se Trumpi mund të takohet me presidentin rus, Vladimir Putin, në udhëtimin e tij në Evropë për samitin e NATO-s.
Mirëpo Stoltenberg ka thënë se nuk e ka problem samitin Trump-Putin. "Ne mbështesim dialogun me Rusinë", ka thënë ai. "Nuk duam tjetër luftë të ftohtë. Nuk duam garë armësh. Nuk duam të izolojmë Rusinë", ka thënë shefi i NATO-s.

## Turqia paralajmëron tarifa për importet amerikane

Ankara, 21 qershor - Ministri turk i Ekonomisë, Nihat Zeybekci, ka njoftuar se do të vendosë tarifa të reja me vlerë 267 milionë dollarë mbi mallrat amerikane, duke përfshirë në "listën e saj të zezë" edhe qymyrin, duhanin, orizin dhe arrat.
Sipas ministrit turk, kjo është rrjedhojë e dështimit të negociatave me Uashingtonin. "Ne jemi të angazhuar për marrëdhënie tregtare aktive, dinamike dhe reciproke me ShBA-në, por ndershmëria dhe drejtësia nuk mund të jenë të njëanshme", ka deklaruar Zeybekci, duke shtuar se vendi nuk mund t'ia lejojë vetes që të fajësohet pa të drejtë për sfidat ekonomike të Amerikës.
Të premten Shtetet e Bashkuara do ta ndiejnë edhe peshën e tarifave evropiane mbi produktet e tyre. Komisioni Evropian ka njoftuar se ka aprovuar taksa ndëshkuese mbi eksportet amerikane me vlerë 3.2 miliardë dollarë. Në shënjestër do të jenë motoçikletat, lëngu i portokallit, uiski, gjalpi i kikirikut, varkat me motorë, cigaret dhe xhinset. "Nuk deshëm të gjendeshim në këtë pozicion, por vendimi i njëanshëm dhe i pajustifikuar i Shteteve të Bashkuara nuk i la Bashkimit Evropian asnjë zgjidhje tjetër", ka deklaruar komisionarja e Tregtisë, Cecilia Malmstrom.






RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

E rrallë

# Qyteti që vret banorët



Shumë njerëz kanë humbur shumicën e familjes sepse dikur jetonin në Wittenoom. Qyteti në Australinë Perëndimore u ngre rreth një miniere asbesti në vitet 1940 dhe '50. Por shumë njerëz në Wittenoom nuk ishin në dijeni se fibrat e azbestit mund të shkaktojnë sëmundje të mushkërive dhe kancer. Qindra, ndoshta mijëra banorë, kanë vdekur që nga momenti i ekspozimit ndaj asbestit. Miniera u mbyll në vitin 1966, por qyteti është ende i ndotur dhe është pothuajse tërësisht i braktisur.

## BARSOLETA E DITËS



**Infermierja: I ke marrë barnat, fashat, shiringat dhe infuzionet?**
**Pacienti: Po.**
**Infermierja: Jastëkun dhe çarçafin?**
**Pacienti: Po.**
**Infermierja: Po ky personi me ju, kush është?**
**Pacienti: Ky është mjeku. E kam sjell nëse nuk keni.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo






**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

### "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**







**Në ora 22:00**

### "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

FOTO E DITES




Hija e një studenti të shkollës indiane shihet në kampin joga në Hyderabad. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Koreanë jugorëve nuk u lejohet më të hanë mish qeni



Një gjykatë në Korenë e Jugut e ka futur vrasjen e qenve për mish në aktivitetet e paligjshme, duke u dhënë zemër aktivistëve për të drejtat e kafshëve, të cilët thonë se një vendim i tillë mund të bëjë që ngrënia e qenve të konsiderohet jo e ligjshme. Mishi i qenit ka qenë prej kohësh pjesë e kuzhinës tradicionale koreane-jugore, me rreth një milion qen në vit të konsumuar.



**DASHI**
Jeni disi nën presion për një çështje të caktuar dhe kjo gjë ju ka bërë nervoz me ata persona që ju gjenden pranë. Duhet të vendosni ekuilibra të brendshëm.



**DEMI**
Me ngarkesën e kohëve të fundit jeni mjaft të dëshiruar për një vend të qetë për të pushuar. Po përzgjidhni ato destinacione që keni kohë që po i mendoni.



**BINJAKËT**
Sot vetmia ju ka mposhtur dhe çdo moment po e shihni gotën gjysmë bosh. Në ditë të tilla është mirë të qëndroni vetëm me njerëz ekspresivë.



**GAFORRJA**
Romantizmi juaj tipik sot do të marrë krah dhe do ta prekë zemrën e partnerit. Ndiheni të mbushur me energji të mirë këto ditë.



**LUANI**
Keni filluar të llogarisni shumë gjërat që do të bëni në të ardhmen. Duke bërë kaq shumë plane nuk po shijoni spontanitetin e ditës.



**VIRGJËRESHA**
Përvoja është një vlerë e shtuar që ju lejon të jeni më të sigurt në hapat që hidhni dhe të mos rrezikoni aty ku mendoni që ka diçka.



**PESHORJA**
Sot do të eksploroni ambiente të reja me të cilat mbase do të jeni shumë të lidhur pak më vonë.



**AKREPI**
Po bëni bilancin e ngjarjeve të fundit dhe doni të shikoni se ku keni arritur me investimet që keni bërë si në fushën e ndjenjave dhe në atë financiare.



**SHIGJETARI**
Sot do të jeni ju iniciatorët e një udhëtimi me miqtë që në fund të ditës do t'ju kënaq të gjithëve. Ideja juaj do të vlerësohet.



**BRICJAPI**
Jeni në një pikë mjaft pozitive për jetën tuaj, por drejtimi që do të merrni mund të lëkundet nga një situatë disi dramatike. Do të arrini ta tejkaloni.



**UJORI**
Po e përballoni mjaft mirë fluksin e punës nga problemet që po ju dalin rrugës. Edhe pse mund t'ju duken të pazgjidhshme për momentin, do t'i rregulloni më pas.



**PESHQIT**
Me altruizmin që ju karakterizon do të zgjidhni punë mjaft shpejt me një të lindur të shenjës së Shigjetarit dhe me kalimin e kohës do ta konsideroni mik.

# Pete Davidson e konfirmon fejesën me Ariana Granden



Tashmë është zyrtare. Pete Davidson dhe Ariana Grande janë fejuar. Ylli i Saturday Night Life e ka konfirmuar fejesën me këngëtaren sa ishte i ftuar në "Tonight Show" të Jimmy Fallon. Fallon e ngacmoi Davidsonin duke i thënë se nuk kishte pse të fejohej me pop yllin në mënyrë që të vinte te emisioni i tij. "Ama [jam fejuar]", ishte përgjigjur komiku, i cili më pas tha se ndihet sikur e ka fituar ndonjë garë.



# E bukura Dua Lipa

Duket se lidhja mes Dua Lipas dhe të dashurit të saj Issac Carew është më e fortë se gjithçka tjetër, pavarësisht se zërat e kronikës "rozë" flasin për një tradhti reciproke. Këngëtarja me origjinë shqiptare është fotografuar me Isaac në ngjarjen e revistës "V" në Nju Jork, duke treguar anën seksi.



# Rikthehet pas gjashtë vjetësh




Këngëtarja që fitoi çmimin Grammy nxori hiret e veta për ballinën e albumit të saj të fundit, "Liberation". Të martën, fotografi Milan Zrnic ka publikuar disa prej fotografive intime të amerikanes Christina Aguilera. Ylli i muzikës është shfaqur e veshur me një xhaketë të zbërthyer teksa shfaqte komplet gjoksin. Këngëtarja ka paralajmëruar edhe një numër të madh të koncerteve që do t'i realizojë gjatë muajve të ardhshëm.

# Futbollisti italian, në deti me të dashurën "bombastike"

Janë të rinj, por dinë si të zbaviten gjatë pushimeve si çift. Federico Bonazzoli (21 vjeç), sulmues i huazuar te Spali nga Sampdoria dhe Angela Nasti (19-vjeçare), motra e bolgeres së famshme Chiara, ndodhen në Mykonos ku po kalojnë pushimet së bashku.





**Autor: GAZMEND MORINA**

MJET KOMUNIKIMI (shq.)
METAFORË E GJATË
SUPER MODELJA BRAZILIANE ADRIANA ....
PARA TË NËNTËS
KËNGA E POPULLARIZUAR / QYTET NË SHQIPËRI
FILOZOF NË GREQINË E LASHTË (shq.)
PARIA E SHOQËRISË (sh.shq.)
FRIKË E MADHE
LLOJ DRURI
PËRFAQËSI DIPLOMATIKE MË E ULËT SE AMBASADA (hist.) / FONI ALBA
AKTORJA ... FRIEL / LLOJI I NJË PRODHIMI SIPAS FORMËS E MADHËSISË
KËNGËTARJA RITA ...
DITMAR HAMAN / SIPËR
AKTORJA JOSIPI
OHAJO, LUIZIANA
NGJYRË E FYTYRËS
PJESË E ILIRISË
KARBON, INTENSITET
INICIATIVA
QYMEZ / ELEMENT KIMIK (SE)
ISH KËNGËTARI AMERIKAN NË FOTO
TUPAN
SHTET NË EVROPË
SCREEN ACTORS GUILD
ZANORE
ZANORE / KËNGËTARJA .... ISTREFI
OSMAN BAJRAMI / KUDRET ISAI
LLOJ PIJE E NXEHTË E ORIENTALE (shq.) / SHTRESË
PUBLICISTI SHQIPTAR ...... YPI
DISIPLINË SPORTIVE / KA A DEM I PATREDHUR (shq.)
NAIM ISMAJLI / SHASTISEM
KRYEQYTETI I JORDANISË
NJOLLA
PEZMATIM I VESHIT / REGJISORI .... SOPI
ISH FUTBOLLISTI SHEARER (orgj.) / LUMË NË AFRIKË
RESHAT ARBANA / SHOSHITET
E NDYRË, BANALE / AKTROJA & MODELJA JOVOVICH
KUJDES I VEÇANTË QË TREGOJMË PËR DIKË / ISMET PEJA
PJESËMARRJA NË NJË GARË / DHËMBOR
MINDERI I ULËT (shq.) / I ÇMENDURI
ZANORE / SHKENCA QË MERRET ME KRIJIMIN E MALEVE
DIÇKA LËNDORE KONKRETE E BOTËS JO TË GJALLË; GJË (shq.)
THIRRJA QË I BËHET MASËS / AI ME TË CILIN QUHEMI
ELEMENT KIMIK (NT) / "RIADI"
BASHKËT.
GJOJA, KINSE / GODINA MBI LUMË
BASHKËT. / NDALIMI
GRYKA E VULLKANIT / NËNË (turq.)
MBRON DIÇKA NGA DIKUSH
FUTBOLLISTI SULLEY (MILAN) / SHKEL E SHKO, RRËMUJË
FUTBOLLISTI SAMUEL ... / LLOJ PAPAGALLI
VETI E ATIJ QË ËSHTË TRIM
ISMET RAMUSHI
TANTAL, REOMIR / BIMË QË PËRDORET PËR TË MBULUAR ÇATITË (shq.)
LETRARI MEHMETI (shq.) / KËNGËTARJA NJOMZA
AZEM MAKSUTAJ / LUMË NË KOSOVË
DY BASHKËTINGËLLORE / PAJTUESHMËRI (krah.)
LËNDË KRISTALORE SHUMË E ËMBËL
KUNDËRSHTAR I BOLSHEVIZMIT RUS / ZANORE
"E" në mes të dy "R" / GROSETO, ATALANTA
BASHKËT.
ALUMIN, AMPER / ARRATISUR
KËNGËTARJA ... FARA / ELIZABETH BANKS
STUHIA E FORTË ME ERË DHE SHI / ZANORE
"LL" pas dy "I"
USHQIM QË SHTROHET E HAHET GJATË PIJES / NATRIUM, TON
"EPOKA ...." / KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK
SHKRIMTARI SHKRELI / ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER
LLOJ BIME NARKOTIKE (shq.) / DY BASHKËTINGËLLORE
KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË ... RAMA / ARTIOLA TOSKA
LEJE PËR TË SHKUAR NGA ODA / EDITA SOPJANI
BIXHOZ
KËNGËTARJA VALENTINA / BASHKËT.
VEJAN / ZANORE
ANA RUSO / ISLANDA
EMËR YNI DJALI (shq.)
BANORI I ATIKËS
ZANORE

# SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | 6 | | 9 | | 4 | |
| | 8 | | | | | | | 1 |
| | 9 | 2 | 7 | | 5 | | 3 | |
| | | 4 | | 2 | 6 | | | 5 |
| 6 | | | | | | | | 9 |
| | | 7 | 8 | | | 4 | | |
| | 4 | | 3 | | 1 | 5 | 8 | |
| 5 | | | | | | | 9 | |
| | 7 | | 5 | | 4 | | | 3 |

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: TALESI, ELITAT, LEMERI, LEGATA, FO, ANA, ORA, DM, NISMA, KOTEC, I, OB, SALEPI, EDISON, KRIKET, NI, LARA, OTIT, ALAN, RA, VULGARE, INTERESIM, MILLA, GARIMI, NIMI, A, SENDI, APELI, NITON, P, DEMEK, N, KRATERI, RUAN, MUNTARI, ETO, IR, TAR, DINI, AM, GJT, SAKARINA, ESER, RER, LL, ALA, ELI, URAGANI, ILL, MEZE, ERE, AZEM, KANABISI, INA, IZE, KUMAR, RAMA, I VE, AR, DRITANI, ATIKASI, I.

ZGJIDHJA E SUDOKUT: Kolona I:135 689 742; KII:786 432 951; KIII:492 715 638; KIV:314 926 875; KV:658 147 329; KVI:927 853 416; KVII:249 361 587; KVIII:563 278 194; KIX:871 594 263.

# Libër i shkruar me kompetencë dhe përgjegjësi historike

*Libri "Ilegal viteve shtatëdhjetë", i autorit Gani Sylaj, është mishërim i idealeve më të larta kombëtare të një gjenerate veprimtarësh idealistë. Ky rrëfim i gjatë në vetën e parë i Gani Sylajt është një dëshmi pothuajse e përkryer e një kohe të vështirë, ku sa vinte e shtohej shtypja kombëtare ndaj shqiptarëve, shfrytëzimi ekonomik i Kosovës dhe mohimi i të drejtave elementare të njeriut, deri tek e drejta për jetë. Gani Sylaj me anë të këtij libri u ka dhënë vulë përpjekjeve të organizuara çlirimtare të viteve shtatëdhjetë, ku edhe vetë ishte ndër protagonistët kryesorë*

**Ismet RASHITI**



Ka vite që nuk kam lexuar një libër me kaq pasion sa librin e autorit Gani Sylaj me titull mjaft domethënës, "Ilegal viteve shtatëdhjetë". Sa herë që lexoja dhe në disa raste rilexoja pjesë nga ky libër, bëja të vetmen pyetje: Përse vallë një autor i këtij kalibri si Gani Sylaj e ka ndrydhur kaq gjatë imagjinatën dhe penën e tij të artë, për ngjarje kaq të rëndësishme historike. Athua pse ka qenë dashur kaq gjatë të presin lexuesit për librin "Ilegal viteve shtatëdhjeta", kur një gjë e tillë, kam bindjen, është varur ekskluzivisht nga vetë autori, Gani Sylaj, si një nga protagonistët kryesor të lëvizjes ilegale gjatë viteve '70-ta e deri në ditët e sotme. Ndoshta, pikërisht tani ka qenë momenti më i duhur që të dalë në dritë një libër i këtij niveli që paraqet në mënyrë objektive e me kaq shumë sinqeritet një periudhë të rëndë e me shumë të papritura të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. E rëndësishme është se autori Gani Sylaj ka qëndruar vertikalisht përgjatë gjithë jetës së tij në shërbim të çlirimit dhe bashkimit të tokave shqiptare. Sigurisht angazhimi i përditshëm, rrethanat ekonomike, ndjekjet dhe burgosjet e njëpasnjëshme kanë qenë arsye të bollshme që libri "Ilegal i viteve shtatëdhjetë" nuk e ka parë dritën e botimit më herët.

Libri i Gani Sylajt me titull "Ilegal viteve shtatëdhjetë" është libri më autentik për një periudhë të rëndë e më shumë të papritura për lëvizjen ilegale. Në fakt këtë libër e bën të veçantë mënyra e rrëfimit të së vërtetës pa fije subjektivizmi, duke paraqitur ngjarje herë-herë dramatike, por gjithnjë me kujdes të shtuar që të mos i kalon kufijtë e së vërtetës. Gani Sylaj, veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare, ish i burgosur dhe i përndjekur politik, trajton kujtimet e tij pa asnjë dozë subjektivizmi, e në disa raste edhe bie në grackën e modestisë së tepruar në mënyrë që e vërteta për këtë periudhë dhe sidomos aksionet ilegale që janë kryer të dalin sa më origjinale dhe objektive. Në këtë rrafsh, autori kujdes të veçantë i kushton lidhjes së fuqishme që ka ekzistuar nga një periudhë në tjetrën të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare rreth boshtit kryesor për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e trojeve shqiptare. Vitet shtatëdhjeta nuk janë gjë tjetër përpos vazhdimësie e idealeve të gjeneratave pararendëse si Rifat Berisha, Kadri Halimi, Shaban Shala, Fazli Grajçevci, Adem Demaçi, Metush Krasniqi e shumë të tjerë të cilët i dhanë jetë rezistencës kombëtare në kohë dhe periudha të ndryshme.

Fillet e këtij organizimi, në kushte tepër të rënda dhe në ilegalitet të thellë, konkretizohen në verë të vitit 1972 me themelimin e celulës në shtëpinë e Mehmet Hajrizit, ku bënin pjesë Mustafë Ademi, Mehmet Hajrizin dhe Gani Sylaj, ndërkaq krah tyre gjithnjë qëndronin edhe Hamide e Hagjere Sylajsi një bërthamë e shëndetshme për të vazhduar pastaj lidhjet me Kadri Osmanin, Rexhep Malajn, Kadri Zekën, Xhafer Shatrin, Hydajt Hysenin, Jashar Alinë e shumë atdhetarë të tjerë, për të ardhur pastaj me zgjerimin organizativ edhe me Azem Sylajn e Jakup Krasniqin, Enver Dugollin, Fehmi dhe Ilmije Plakajn, dy motrat, Hamiden e Haxherën dhe vëllanë Ismail Sylaj të cilët në vazhdimësi u dëshmuan me kontributin e tyre atdhetar, deri te lufta e fundit çlirimtare.

Veprimi në kushte të rënda, mungesa e mjeteve teknike dhe financiare, paraqitnin vështirësi të mëdha në realizimin e objektivave të lëvizjes, e cila edhe në këto rrethana sa vinte e rritej. Aksionet e njëpasnjëshme për shpërndarjen e trakteve, shkruarja e parullave dhe sidomos botimi i gazetës "Zëri i Kosovës", ishin ndër detyrat kryesore të celulës. Këto nuk kishin si të mos u binin në sy pushtetmbajtësve, ndaj kishin filluar përgjimet, ndjekjet dhe burgosjet të cilat paraqitnin peripeci të shumta në kryerjen e detyrave dhe zgjerimin e mëtutjeshëm të radhëve. Ndër aksionet më të organizuara në përmasa të gjëra, ishte shpërndarja e trakteve në Qendrën e Studentëve të Prishtinës, më 1974 nga Rexhep Malaj, Kadri Zeka, Gani Sylaj dhe Hydajet Hyseni.

Të tilla veprimtari ishin të shumta në vende dhe momente të caktuara, varësisht nga nevoja dhe situata politike që mbretëronte në vend. Duhet theksuar se në të gjitha këto raste autori ose ishte pjesëmarrës i drejtpërdrejtë, ose ishte në dijeni, ndaj i përshkruan të gjitha me kompetencë dhe përgjegjësi të plotë publike ashtu siç kanë ndodhur në të vërtetë në kohë dhe hapësirë, pa hiperbolizime dhe përshtatje sipas nevojave ditore.

Libri "Ilegal viteve shtatëdhjetë", i Gani Sylajt, sado që duket një rrëfim në vetën e parë, në fakt paraqet një plejadë të artë veprimtarësh të këtyre viteve të cilët me përkushtim dhe atdhetarizëm i dhanë hovë Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Guximi, pjekuria politike, modestia dhe qëndresa nëpër burgjet e tmerrshme ish-jugosllave të këtij brezi atdhetarësh, dosido u bënë frymëzim për gjeneratat e mëvonshme deri te themelimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Që të mos ndalem në çdo ngjarje apo te secili protagonist veç e veç, me një fjalë mund të them se Gani Sylaj si një mjeshtër i përkryer ka ditur t'i gdhendë për mrekulli të gjithë njësoj dhe t'i radhisë aty ku e kanë vendin. Këtë mund ta bëjnë vetëm autorët e profilit të Gani Sylajt, të cilët në asnjë rast nuk vuajnë nga subjektivizmi dhe megalomania. Është e vetëkuptueshme se autori në të gjitha rastet veç e veç dhe në tërë strukturën e rrëfimit në librin "Ilegal viteve shtatëdhjetë", mbi gjithçka tjetër ka pasur çështjen kombëtare. Si fëmijë i frymëzuar në odat tradicionale të Drenicës, si nxënës shembullor, si student, si piktor, si mësues dhe si i organizuar në lëvizjen ilegale politike, gjithnjë ka qenë i përkushtuar për çlirim kombëtar dhe bashkimin e trojeve shqiptare të ndara padrejtësisht. Gani Sylaj ka ditur ta kombinojë për mrekulli veprimtarinë legale me atë ilegale, duke pasur për qëllim çdoherë dhe kudo që i ka shkelur këmba zgjidhjen e kauzës kombëtare shqiptare. Dashuria për tokën e të parëve, lidhja emocionale me Drenicën dhe viset e tjera shqiptare kishin bërë që Ganiu të kthehej nga Parisi i bukur, ku ishte strehuar për një kohë bashkë me motrën dhe Mehmet Hajrizin për t'i ikur përkohësisht ndjekjes nga UDB-a. Në librin "Ilegal i viteve shtatëdhjetë", Gani Sylaj bashkë me tërë këtë plejadë veprimtarësh, dalin si udhëheqës të thjeshtë që jetonin e merrnin frymë me hallet e popullit, si diplomatë të pjekur, si organizatorë dhe strateg dhe si guximtarë të pashoq për realizimin e aspiratave shekullore të shqiptarëve.




Autori i librit "Ilegal viteve shtatëdhjetë", Gani Sylaj, ka bërë përpjekje të mëdha që brenda kopertinave të këtij libri të shkruajë deri në hollësi për të gjitha takimet dhe kontributin e secilit që ka dhënë në rrethanat ekzistuese. Kolegët e shkollave ku ka punuar, nxënësit e dalluar dhe bashkëveprimtarë të dalluar siç është edhe ish-ushtari i UÇK-së, Idriz Mehmeti, i përshkruan me dashamirësi, duke ndarë së bashku çdo sukses të arritur. Ganiu gëzohej qoftë edhe me një fjalë të mirë, me një poezi patriotike, e me një pjesë teatrale që sadopak shkonte në favor të çështjes kombëtare shqiptare. Problem në vete ishte ruajtja e materialeve ilegale si shkrimet për "Zërin e Kosovës", traktet e librat, ndaj flet me admirim për të gjithë miqtë që e ndihmuan në ato ditë të vështira. Nxjerrja e "Zërit të Kosovës" në rrethana të jashtëzakonshme me vizatimet e tij në faqen e parë, ishin momentet më të vështira, pasi që, përveç rrezikut nga UDB-a, barra më e rëndë qëndronte në përgjegjësinë politike e organizative që i kishte mbetur mbi supe pa dëshirën e tij. Burgosja e shokëve dhe shkëputja e lidhjeve kishin bërë që Gani Sylaj të shumë momente të ndodhej në situata të rënda e përplot rreziqe. Natyrisht këto nuk e thyen për asnjë moment nga qëllimi i tij final që ishte çlirimi i Kosovës nga okupatori serb.

Përdorimi i drejtë i gjuhës, mënyra e veçantë e rrëfimit të ngjarjeve përmes një përshkrimi të hollësishëm si dhe përdorimi i figurave në vend të duhur dhe me shkak, kanë bërë që autori të mos bjerë në kurthin e areales siç po ndodh, fatkeqësisht, te shumë autorë ambiciozë. Falë stilit të rrjedhshëm, shprehjes së fuqishme edhe për gjërat më të thjeshta, libri bëhet shumë i kuptueshëm dhe tërheqës për lexim nga të gjitha shtresat. Libri "Ilegal i viteve shtatëdhjetë", i autorit Gani Sylajt, është i shkruar me kompetencë dhe përgjegjësi të lartë historike që lexohet me një frymë.




# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | NIGERIA - ICELAND | 2 | SERBIA - SWITZERLAND | 2 | BRAZIL - COSTA RICA | 1 |

# Shqipet e Zvicrës sot përballen me Serbinë

Zvicra e Behramit, Xhakës, Shaqirit dhe Xhemailit sonte, me fillim nga ora 20:00. përballet në Kupën e Botës me Serbinë. Fitorja ndaj kësaj skuadre për futbollistët me prejardhje shqiptare është më shumë se një triumf i zakonshëm në sport

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kombëtarja e Zvicrës, pas mrekullisë që bëri në ndeshjen ndaj Brazilit, sonte (e premte) përballet me Serbinë. Kjo ndeshje është e veçantë pasi vazhdon të ketë ende tensione në mes të shqiptarëve dhe serbëve, e ku në këtë ndeshje pritet të luajnë që nga fillimi katër yjet e Zvicrës që janë me prejardhje shqiptare: Valon Behrami, Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri dhe Blerimi Xhemaili. Suksesi në ndeshjen e parë ndaj Brazilit favorit dhe rivali i sotëm është një detyrim për shqiptarët që të triumfojnë dhe ta vazhdojnë rrugëtimin në Kupën e Botës. Serbia e mposhti në ndeshjen e parë Kosta Rikën dhe është e para në grup me tri pikë, por ndeshjet e dyta do të bëjnë ndryshime në pikët e Grupit E. Kjo ndeshje ka zënë një vend të rëndësishëm jo vetëm në mediet shqiptare, por edhe ato zvicerane dhe serbe. "Me Xhemajlin, Xhakën, Shaqirin e Behramin, katër lojtarë të Zvicrës me prejardhje shqiptare, ndeshja për shumëkënd interpretohet si duel midis Serbisë dhe Shqipërisë", shkruan tabloidi zviceran "20min".

Ndërsa mediet serbe po i pengon fakti se në këpucët e Shaqirit është i vendosur edhe flamuri i Kosovës. Për këpucët e Xherdan Shaqirit ka shkruar edhe prestigjiozja britanike "The Guardian": "Kur Xherdan Shaqiri do të ecë nëpër Kaliningrad, ai nuk do të ketë mbathur vetëm një këpucë sportive. Në anën e djathtë të këpucës ai do ta ketë edhe flamurin e Kosovës".

Ndërkohë ylli i skuadrës së Arsenalit, Granit Xhaka, ka thënë se në ndeshjen ndaj Serbisë, duhet të luftohet për fitore. "Absolutisht i përqendruar dhe i gatshëm për të luftuar në ndeshjen tonë të ardhshme. Kurrë mos hiqni dorë, gjithmonë luftoni", ka thënë Xhaka.

Në kuadër të këtij grupi zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Brazilit dhe Kosta Rikës nga ora 14:00. Sot (e premte) zhvillohet edhe ndeshja e Grupit D në mes të Nigerisë dhe Islandës.

**GRUPI D**
17:00 Nigeri-Islandë

**GRUPI E**
14:00 Brazili-Kosta Rika
20:00 Serbia-Zvicra

## Franca siguron kualifikimin. Danimarka dhe Australia ndahen në 'paqe'

Kualifikimin në fazën tjetër të Botërorit e ka siguruar Franca, pasi e ka mposhtur Perunë me rezultat 1-0. Franca dominoi në takim deri në minutën e 34-t, kur Kylian Mbappe shënoi për 1-0. Në vazhdim të ndeshjes francezët më shumë e ruajtën rezultatin, kurse Perusë pa sukses i përfundonin aksionet dhe ndeshja përfundoi 1-0. Franca tashmë është kualifikuar, pasi është ka arritur gjashtë pikë, ndërsa Danimarka, pas barazimit ndaj Australisë (1-1), ka katër pikë dhe zë vendin e dytë, kurse një pikë kanë grumbulluar australianët, derisa Peruja mbetet në kuotën e 0 pikëve. Në ndeshjen e zhvilluar në mes të Danimarkës dhe Perusë, rezultati final ishte 1-1. Për danezët shënoi Christian Eriksen (7), kurse australianët barazuan nga penalltia nëpërmjet Mile Jedinak (38).

**GRUPI C**

| | |
|---|---|
| Danimarkë-Australia | 1-1 |
| Francë-Peru | 1-0 |

**Tabela**

| | |
|---|---|
| 1. Franca | 6 pikë |
| 2. Danimarka | 4 |
| 3. Australia | 1 |
| 4. Peru | 0 |

## SHKURT

### Drita në Gjibraltar

Kampionia e Kosovës në futboll, Drita e Gjilanit, ka udhëtuar të enjten drejt Gjibraltarit për t'i zhvilluar ndeshjet e Ligës së Kampionëve. Drita më 26 qershor do ta zhvillojë ndeshjen e parë në historí të klubit në garën më prestigjioze në planet, Ligën e Kampionëve. Kjo ndeshje do të zhvillohet në Victoria Stadium nga ora 17:00, ku skuadra jonë përballë do t ketë ekipin FC Santa Coloma, e cila është kampione e Andorrës.

### Durmishi kalon të Lazio

Riza Durmishi është zyrtarizuar si lojtar i Lazios. Shqiptari nga Tetova gjatë ditës se enjte i ka kryetar testet mjekësore në skuadrën italiane, kurse do të jetë shqiptari i tretë në këtë klub, pas portierit Thomas Strakosha dhe drejtorit sportiv Igli Tare. Durmishi ka luajtur për Real Betisin dhe Brondbyn.

### Sejdiu përforcon Vëllaznimin

Njëri nga lojtarët më të talentuar në futbollin e Kosovës, Florent Sejdiu i është bashkuar skuadrës së Vëllaznimit nga Gjakova. Ai ka nënshkruar kontratë me skuadrën kuqezi për edicionin 2018/2019, kurse në këtë skuadër Florent Sejdiu do të punojë në këtë skuadër me babai e tij, Gani Sejdiu që është trajner.

### Trepça '89 mirëkupton Prishtinën, pritet edhe Gjilani

Skuadra e Trepçës '89 e ka mirëkuptuar skuadrën e Prishtinës, pasi ka pranuar ta lirojë futbollistin Argjend Mustafa që t'i bashkohet kryeqytetasve. FC Prishtina nëpërmjet një njoftimi për medie e ka falënderuar skuadrën nga Mitrovica dhe kryetarin e saj, Abedin Zeka që e ka liruan mesfushorin Mustafa pa asnjë kompensim. Kryeqytetasit presin të hasin në mirëkuptimin edhe të skuadrës së Gjilanit për dyshen Armend Thaqi dhe Leotrim Bekteshi.

## Veseli: Puna e Vokrrit, model për gjeneratat e reja



PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur në një takim familjarët e Fadil Vokrrit. Veseli e ka vlerësuar punën që ka bërë Fadil Vokrri, duke thënë se ajo do të jetë model për gjeneratat e reja. "Me familjen e legjendës sonë Fadil Vokrri sot me emocion kujtuam jetën e tij plot suksese. Puna e tij për vendin do të jetë model për gjeneratat e reja. Ne do ta nderojmë dhe respektojmë gjithmonë trashëgiminë e Vokrrit", ka shkruar Veseli. Legjenda e futbollit të Kosovës dhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, ndërroi jetë ditë më parë, pas një sulmi në zemër.

## Reus: Dua të luaj që nga fillimi ndaj Suedisë



Moskë, 21 qershor - Ylli i Gjermanisë, Marco Reus, kërkon nga trajneri Joachim Low ta inkuadrojë që nga fillimi në ndeshjen e dytë të Botërorit, e cila zhvillohet të shtunën ndaj Suedisë. "Kam qenë për një kohë të gjatë i dëmtuar, por tani kam rigjetur ritmin tim. Të gjithë kanë dëshirë të luajnë dhe unë jam një prej tyre. Trajneri Low i di aftësitë e mia, ndaj shpresoj të jem në fushë për t'i ndihmuar shokët e skuadrës. Se në çfarë pozicioni nuk më intereson, rëndësi ka të jem aty. Por, siç thashë, kjo do të varet nga zgjedhjet që do të bëjë trajneri. Ai e di se çfarë duhet ndryshuar për mirë në skuadër", ka deklaruar Reusi.

# Flamuri i Kosovës u ngre në Tarragona, sot fillojnë garat




PRISHTINË, 21 QERSHOR - Flamuri i Kosovës për herë të parë është ngritur në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Në ceremoninë e himnit të Kosovës dhe ngritjes së flamurit mori pjesë shefi i misionit të ekipit të Kosovës, Jeton Rudari. Flamuri i Kosovës u ngre përkrahë 25 flamujve të tjerë të shteteve pjesëmarrëse në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018".
Ekipi i shigjetarëve të Kosovës, i cili të mërkurën mbrëma arriti në Tarragona, të enjten ka zhvilluar përgatitjen e parë me trajnerin Fehmi Bylykbashi. I pranishëm ishte edhe kryetari i Federatës së Shigjetarisë së Kosovës, Agron Mala. Të tre shigjetarët, Atdhe Luzhnica, Hazir Asllani dhe Ardita Zejnullahu, do të garojnë në disiplinën Recurve. Pas Shigjetarisë, në Tarragona ka arritur edhe delegacioni i dytë, i prirë nga presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj.
Pjesë e ekspeditës ishin edhe ekipi i karatesë, notit, peshëngritjes dhe shenjëtarisë sportive, të cilët garat i fillojnë pas dy ditësh. Ceremonia hapëse e Lojërave Mesdhetare "Tarragona 2018" do të mbahet sot (e premte), në stadiumin e Gimnastic Tarragona, duke filluar nga ora 21:00. Bartës i flamurit të Kosovës do të jetë karateisti Herolind Nishevci, vendim ky të cilin e mori mbrëmë Bordi Ekzekutiv i KOK-ut, pasi ekipi i xhudos do të udhëtojë më vonë drejt Tarragonas. Lojërat Mesdhetare mbyllen më 1 korrik.

# Nadali: Ja pengu më i madh i karrierës sime



MADRID, 21 QERSHOR - Karriera e Rafael Nadalit është e mbushur me shumë fitore, por jo gjithnjë gjërat kanë shkuar "vaj" për tenistin spanjoll. Numri 2 për momentin në botë në një intervistë për "Mundo Deportivo" ka rrëfyer për pengjet që ai ka në karrierë. "Unë jam një nga ata që them se nuk do të do të ndryshoja asgjë nga e kaluara ime, por në të vërtetë diçka do të përmirësoja", ka thënë spanjolli. "Në mjaft situata do të kisha marr vendime ndryshe, por ndonjëherë je i detyruar të marrësh vendime pa u menduar shumë, duke marrë përsipër edhe riskun, sidomos në nivelin fizik. Çfarë do të ndryshoja? Kur bëra disa infiltrime në gju në vitin 2012, gjatë Wimbledonit. Në atë turne humba ndaj Rosolit dhe u detyrova të qëndroja pushim deri në 2013-n. Edhe në vitin 2016 bëra të njëjtin gjë në pulsin e dorës dhe e pagova sërish shtrenjtë", ka deklaruar Nadal. "E qartë që do të merrja një vendim ndryshe, por e ndieja se po luaja mirë, në gjendje për ta fituar Roland Garros, ndaj dhe mora atë vendim", rrëfehet Rafael Nadal. "Megjithatë, jam i kënaqur me vendimet që kam marrë, përndryshe nuk do të kisha arritur deri këtu. Ndonjëherë luaj përtej limiteve të mia fizike, rrezikoj shumë dhe me siguri do ta vuaj këtë gjë në të ardhmen. Ky është një sport i vështirë dhe luajmë në sipërfaqe agresive", u shpreh tenisti spanjoll.

## SHKURT

### Beckham: Angli - Argjentinë, finalja e Botërorit

Legjenda e Manchester Unitedit dhe Real Madridit, David Beckham, ka thënë se finalja e Kupës së Botës do të jetë në mes të Anglisë dhe Argjentinës. "Unë besoj se Argjentina do të luajë kundër Anglisë në finale të këtij Botërori. Njëra zgjedhje e imja për finalen është Anglia, por ndoshta jam i njëanshëm dhe i pasionuar për vendin tim", ka thënë Beckham.

### Hierro vlerëson barazimin ndaj Portugalisë më shumë se fitoren ndaj Iranit

Spanja e mposhti Iranin, por trajneri Fernando Hierro nuk është shumë i kënaqur pas kësaj fitore. Në fakt ish-kapiteni i Real Madridit ka thënë se Spanja më mirë luajti në ndeshjen ndaj Portugalisë (3-3) sesa ndaj Iranit (1-0). "Ne morëm tri pikë, katër në tërësi, dhe ndoshta ishim më të mirë kundër Portugalisë sesa ndaj Iranit. Njerëzit thonë se gjërat nuk po funksionojnë, por kemi katër pikë. Sigurisht, duam të jemi edhe më të mirë, por çdo ekip do të vuajë në këtë Botëror", ka thënë Hierro, duke shtuar: "Kushdo që dëshiron të fitojë një Kupë Bote në Rusi do të vuajë. Është e vërtetë, ndoshta ishim më të lumtur pas Portugalisë, por sot kemi marrë tri pikët e mundshme".

### Juve transferon Emre Canin

Mesfushori Emre Can i ka kaluar testet dhe është prezantuar te skuadra e Juventusit. Futbollisti gjerman që nuk u grumbullua nga trajneri Joachim Low për Kupën e Botës ka nënshkruar kontratë katërvjeçare me skuadrën kampione të Italisë, Juventus. Emre Can, përveç Liverpoolit, ka luajtur edhe për Bayer Leverkusen dhe Bayern Munchen.

### Ozili: Ja pse nuk e këndoi himnin e Gjermanisë

Mesut Ozili vazhdon të kritikohet për foton e publikuar me Erdoganin, por edhe për shkak se nuk e këndon himnin e Gjermanisë. "Qëkur ishim në shkollë të vegjël, kur këndohej himni, unë lutesha. Tani ndodh e njëjta gjë. Sa herë dalim në fushë dhe këndohen himnet, unë lutem. Nuk besoj se është e drejtë të kritikohem për këtë gjë", ka thënë Ozil.

### Ramosi, Maradonës: Të gjithë e dinë se je shumë larg Messit

Vijon debati në mes të Diego Maradonës dhe Sergio Ramosit. Ky i fundit ka thënë se Leo Messi është larg më i mirë se Maradona kurse, sipas tij, këtë gjë e dinë të gjithë në Argjentinë. "Maradona ka qenë një fenomen, por në Argjentinë e dinë të gjithë që ai është vite dritë larg futbollistit më të mirë argjentinas të të gjitha kohëve, që për mua është Leo Messi", ka thënë Ramos, i cili është kapiten i Kombëtares së Spanjës.

UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"

Rr. ISMAIL QEMALI, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831

**Data: 21.06.2018**
**Nr.ref: 03/605**

Universiteti i Gjakovës, në bazë të Ligjit të Punës, Nr.03/L-212 si dhe Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani", shpall:

## KONKURS

**- Zyra e Personelit-**

**-Vozitës në Rektorat - (1 nëpunës/e)-**

**Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin e Punës, 03/L-212, si dhe Udhezimit Administrativ (MPMS) NR.07/2017 për Rregullimin e Procedurave ne Sektorin Publik duhet ti plotësojnë edhe këto kushte:**

I. Detyrat – përgjegjësitë:

1. I drejton veturat që i ka në dispozicion Universiteti, sipas urdhërit të shkruar dhe gojor të Rektorit, të Prorektorëve dhe të Sekretarit të Përgjithshëm;
2. Ngarkohet me veturat e Rektoratit të Universitetit të Gjakovës dhe kujdeset për mirëmbajtjen, pastërtinë dhe gjendjen e tyre të rregullt teknike;
3. Është shofer për Rektorin, për Udhëheqësit e tjerë të Universitetit dhe sipas nevojës edhe për personelin e Universitetit;
4. Kryen intervenime të vogla teknike në vetura;
5. Mban evidencë për kilometrazhin e kaluar dhe për shpenzimet e lëndëve djegëse dhe të mjeteve të tjera shpenzuese për veturat që i drejton sipas rregullores për shpenzime të automjeteve;
6. Së bashku me zyrtarin përkatës kujdesen për kohën e regjistrimit të automjeteve;
7. I kryen edhe punët e pranim-dorëzimit të dërgesave të postës, sipas nevojës i kryen punët e portierit dhe të korrierit;
8. Kryen edhe punë të tjera të cilat ia caktojnë udhëheqësit.

**II. Nëpunësi mbikëqyrës:**
Sekretari i Përgjithshëm

**III. Kualifikimi dhe aftësitë:**
Përgatitja shkollore e mesme; posedimi i patentë shoferit; e dëshirueshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

**IV. Përvoja e përgjithshme:**
Minimum 1 (një) vit përvojë pune nga fusha të ngjashme.

**V.Kohëzgjatja**:
E pacaktuar

Konkursi mbetet i hapur deri me dt.06.07.2018 (15 ditë kalendarike). Paraqitja e dokumenteve bëhet në zyrën e Arkivit në ndërtesën e Rektoratit të Universitetit "Fehmi Agani" Rr Ismail Qemali pn, Gjakovë.

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- Një letër motivuese, duke përshkruar poziten për të cilën aplikoni
- CV-në
- Dëshmi mbi shkollimin e kryer ( kopja e diplomës e noterizuar)
- Dokumente tjera relevante për pozitën që aplikoni
- Çertifikata se nuk jeni nën hetime, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë: www.uni-gjk.org

UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"

Rr. ISMAIL QEMALI, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831

**Data: 21.06.2018**
**Nr.ref: 03/605**

Univerzitet Djakovice, na osnovu Zakona o Radu, br. 03/L-212 kao i Pravilnika o Unutrašnjoj Organizaciji i Sistematizaciji Radnih Mesta na Univerzitetu Djakovice "Fehmi Agani", objavljuje:

## KONKURS

**- Kancelarija Osoblja -**

**-Vozač u Rektoratu - (1 službenik/ca)-**

**Kandidati koji konkurišu za ovo radno mesto, osim opštih uslova predvidjenih Zakonom o Radu, 03/L-212, kao i Upravne Uredbe (MRSZ) BR.07/2017 o Regulisanju Postupaka u Javnom Sektoru trebaju ispuniti i sledeće uslove:**

I. Dužnosti – odgovornosti:

1. Vozi kola kojima raspolaže Univerzitet, prema pismenom i usmenom nalogu Rektora, Prorektora i Generalnog Sekretara;
2. Zadužuje se kolima Rektorata Univerziteta Djakovice i postara se o njihovom održavanju, čistoći i regularnom tehničkom stanju;
3. Je vozač za Rektora, za druge rukovodioce Univerziteta i prema potrebi i za osoblje Univerziteta;
4. Vrši male tehničke intervencije na kolima;
5. Drži evidenciju o predjenom kilometražu i o potrošnji goriva i drugih potrošnih sredstva za kola koja vozi prema pravilniku o troškovima vozila;
6. Zajedno sa odgovarajućim službenikom staraju se o vremenu registracije vozila;
7. Vrši i poslove primanja-predaje poštanskih pošiljaka, prema potrebi vrši poslove portira (vratara) i kurira;
8. Vrši i druge poslove koje mu rukovodioci odredjuju.

**II. Nadzorni službenik:**
Generalni Sekretar

**III. Kvalifikacija i sposobnosti:**
Srednja školska sprema; posedovanje vozačke dozvole; poželjno je poznavanje rada sa računarom i poznavanje engleskog jezika.

**IV. Opšte iskustvo:**
Jedna (1) godina radnog iskustva sa sličnih polja.

**V. Trajanje**:
Neodredjeno

Konkurs ostaje otvoren do 06.07.2018 (15 kalendarskih dana). Prijava dokumenata se vrši u kancelariji Arhiva u zgradi Rektorata Univerziteta "Fehmi Agani" Ulica Ismail Qemali bb, Djakovica

Molbi/Zahtevu treba priložiti i sledeće dokumente:

- Jedno motivacijsko pismo
- Životopis
- Dokaz o završenom školovanju (kopija ovjerene Diplome)
- Druge relevantne dokumente o položaju za koji konkurišete
- Uverenje da niste pod istragom, ne starija od šest (6) meseci

Molbe podnesene posle predvidjenog roka se neće primati a nekompletne molbe biće odbijene.

Samo izabrani kandidati u užoj listi će biti kontaktirani.

Konkurs se može naći objavljen i na strani interneta na sledećoj adresi: www.uni-gjk.org.

UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"

Rr. ISMAIL QEMALI, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831

**Data: 21.06.2018**
**Nr.ref : 03/604**

Universiteti i Gjakovës, në bazë të nenit 22 pika 1.7, nenit 28 pika 1.5 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik të Gjakovës dhe Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani", shpallë :

## KONKURS

**-Departamenti i Administratës së Përgjithshme-**

**-Zyrtar/e për Administrimin e Teknologjisë Informative - TI (1 nëpunës/e)**

**Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për Shërbyesit Civilë të Republikës së Kosovës, nr 03/L-049, duhet ti plotësojnë edhe këto kushte:**

**Detyrat Kryesore:**

1. E administron web-faqen e Universitetit dhe njësive të tij.

2. Përgatitë dhe operon me të dhënat e studentëve nga procesi i regjistrimit deri tek diplomimi, përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Studentëve;

3. U jep përkrahje personelit akademik dhe administrativ për sistemet e TI në Universitet;

4. Jep përkrahje softuerike dhe harduerike për Universitetin dhe Fakultetet;

5. Jep përkjahje për rrjetin dhe internetin e Universitetit dhe Fakulteteve;

6. E pregaditë konfigurimin e kompjuterëve për operim funksional;

7. Ndihmon në implementimin e proceseve administrative;

8.Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton Sekretari i Përgjithshëm.

**Kualifikimi:**
Përgatitja shkollore superiore/Diplomë universitare – FIEK- Drejtimi Kompjuterikë, Telekomunikacion, FSHMN – Drejtimi i Shkencave Kompjuterike; Minimum 2 (dy) vite përvojë pune në fushën përkatëse

**Kohëzgjatja:**
E karrierës

**Qëllimi i vendit të punës**:
Të kryej detyrat dhe përgjegjësitë sipas mandatit brenda njësisë organizative.

**Shkathtësitë**:
- E nevojshme njohja e punës me kompjuter në programet Word, Excel, Corel etj.
- E nevojshme njohja bazike e gjuhëve programuese PHP, HTML, CSS etj.
- Të nevojshme njohuritë bazike në SQL.
- E dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

**Konkursi mbetet i hapur deri me dt.06.07.2018 (15 ditë kalendarike).** Shkarkimi i aplikacioneve bëhet nga web faqja e Universitetit www.uni-gjk.org, ndërsa paraqitja e dokumenteve bëhet në zyrën e Arkivit në ndërtesën e Rektoratit të Universitetit "Fehmi Agani" Rr Ismail Qemali pn, Gjakovë

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- Një letër motivuese
- CV-në
- Dëshmi mbi shkollimin e kryer ( kopja e diplomës e noterizuar)
- Dokumente tjera relevante për pozitën që aplikoni
- Çertifikata se nuk jeni nën hetime, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj

Sherbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.
Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë:
**www.uni-gjk.org**

UNIVERZITET DJAKOVICE
"FEHMI AGANI"

Ul. ISMAIL QEMALI, bb, 50000 DJAKOVICA, Republika Kosovo
Tel.: 038 200 20 831

Datum: 21.06.2018
Nr.Ref: 03/604

Univerzitet Djakovice, na osnovu člana 22 tačka 1.7, člana 28 tačka 1.5 Privremenog Statuta Javnog Univerziteta Djakovice i Pravilnika o Unutrašnjem Organizovanju i Sistematizaciji Radnih Mesta na Univerzitetu Djakovice "Fehmi Agani", objavljuje :

## KONKURS

**-Odeljenje Opšte Uprave-**

**-Službenik/ca za Informativnu Tehnologiju –IT (1 službenik/ca)**

**Kandidati koji konkurišu za ovo radno mesto, osim opštih uslova predvidjenih Zakonom o Gradjanskim Službenicima Republike Kosovo, br. 03/L-049, trebaju ispuniti i sledeće uslove:**

**Glavne dužnosti:**

1. Upravlja web-stranom Univerziteta i njegovih jedinica.

2. Priprema i upravlja sa podacima studenata od procesa registracije do diplomiranja, preko Elektronskog Sistema Upravljanja Studenata;

3. Daje podršku akademskom i upravnom osoblju za sisteme IT na Univerzitetu;

4. Daje softver i hardver podršku za Univerzitet i Fakultete;

5. Daje podršku za mrežu i internet Univerziteta i Fakulteta;

6. Vrši i druge poslove koje mu odredjuje Generalni Sekretar.

**Kvalifikacija:**
Viša školska sprema – FEIK-Pravac Kompjuterstvo Telekomunikacija, FPMN – Pravac Kompjuterske Nauke - (2) godine radnog iskustva na odgovarajućem polju

**Trajanje:**Karijerno

**Sposobnosti**:
- Potrebno je poznavanje rada sa računarom u programima Word, Excel, Corel itd.
- Potrebno je osnovno poznavanje programskih jezika PHP, HTML, CSS etj.
- Potrebno je osnovno poznavanje u SQL.
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

**Konkurs ostaje otvoren do 06.07.2018 (15 kalendarskih dana).** Prijava dokumenata se vrši u kancelariji Arhiva u zgradi Rektorata Univerziteta "Fehmi Agani" Ulica Ismail Qemali bb, Djakovica

Molbi/Zahtevu treba priložiti i sledeće dokumente:
- Jedno motivacijsko pismo
- Životopis
- Dokaz o završenom školovanju (kopija ovjerene Diplome)
- Druge relevantne dokumente o položaju za koji konkurišete
- Uverenje da niste pod istragom, ne starija od šest (6) meseci

Gradjanska Služba Kosova nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i prima molbe od svih lica muškog i ženskog roda od svih zajednica na Kosovu.

Nevećisnke zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravedno i srazmerno zastupanje u organima gradjanske službe centralne i lokalne javne uprave, kao što se navodi u članu 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 o Gradjanskoj Službi Republike Kosovo.

Molbe podnesene posle predvidjenog roka se neće primati a nekompletne molbe biće odbijene.
Samo izabrani kandidati u užoj listi će biti kontaktirani.

Konkurs se može naći objavljen i na strani interneta na sledećoj adresi: www.uni-gjk.org

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Business Support", SH.P.K. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. 70811774 si dhe nr. fiskal: 600762183 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Business Support" D.O.O., Pristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom 70811774 u fiskal: 600762183, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Business Support", L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business 70811774 i number fiskal: 600762183 The company has appointet a liquidator ësho is going to oversee the liquidator process. All clients ëho have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to shoë up ëithin 30 days starting from the day of neëspaper announcement- publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Faton Gërbeshi, shpallë të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

▶ Mimoza Fejza shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme te mjekësisë "Dr. Xheladin Deda" Mitrovicë.

▶ Artan Bytyci shpall te pavlefshme dipllomen shme " Ymer Prizreni " Prizren

▶ Leonis Maloku shpall te pavlefshme deftesat e kl V - lX shf " Vellezerit Frasheri " Planej

▶ Asaf Krasnici shpall t pavlefshme dipllomen shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Agron Lezi shpall te pavlefshme dipllomen shf " Emin Duraku" Prizren

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**
**FAKULTETI JURIDIK**
Studimet Pasdiplomike të doktoraturës
Nr.02/459
Prishtinë 19-06/2018

Në bazë të nenit 127 al.1 të statutit të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina, nenit 17 al. 2 dhe 4, të rregullores mbi studimet shkencore pasdiplomike dhe Vendimit nr. 02/459 nga Mbledhja e Këshilli të Fakultetit Juridik të datës 16.05.2018, si dhe vendimit për ratifikimin nga Senati i UP nr. 1/757 datë 19.06.2018, kandidatit **Ma.sc. Florent Muçaj PhD.c** , i është lejuar mbrojtja publike e disertacionit të doktoratës, andaj mbi bazën e dispozitave të më lartë cekura bëjmë këtë.

**N J O F T I M**

Me të cilin njoftojmë të gjithë të interesuarit, se me datën 04/07/2018, me fillim në ora 13,00h, në Amfiteatrin e vogël të Fakultetit Juridik, kandidati për fitimin e titullit doktor i shkencave Juridike, fusha shkencore Kushtetuese-administrative, Ma.sc. Florent Muçaj PhD.c, bën mbrojtjen publike të disertacionit me titull : **"Roli i Presidentit në funksionimin e sistemit kushtetues dhe në përfaqësimin e unitetit të popullit"**. Para komisionit profesional në përbërje:

1. Prof.Dr.Visar Morina, (Kryetar)
2. Prof.Asoc.Dr. Sokol Sadushi, (anëtar i jashtëm nga shkolla e magjistraturës në Republikën e Shqipërisë)
3. Prof.Ass. Dr.Murat Jashari, (anëtar)

Prishtinë 21/06/2018.

Zyrtari i lartë për studime pasdiplomike:

/ Ma.sc. Shaban Dulahu /



**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Financave / Ministarstvo Finansija / Ministry of Finance*
*Thesari i Kosovës/Trezor Kosova/Treasury of Kosovo*

## Shpallje e Ankandit të Letrave me Vlerë KV010-18

| | |
|---|---|
| Afati dhe Lloji | 5 Vjeçar – Obligacion Qeveritar |
| Shuma e Ofruar | €20,000,000 |
| Kodi i Instrumentit | KV1212331239 |
| Data e Ankandit | 29.06.2018 |
| Data e Shlyerjes | 02.07.2018 |
| Data e Maturimit | 02.07.2023 |
| Mekanizmi i Çmimit | Çmime të Shumëfishta |

Shënim: Qeveria e Republikës së Kosovës rezervon të drejtën për ri-blerje të kësaj Letre me Vlerë nëpërmjet operacioneve të përcaktuara në Rregulloren për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

## Announcement of Securities Auction KV010-18

| | |
|---|---|
| Term and Type | 5 Years – Government Bond |
| Offering Amount | €20,000,000 |
| Instrument Code | KV1212331239 |
| Auction Date | 29.06.2018 |
| Settlement Date | 02.07.2018 |
| Maturity Date | 02.07.2023 |
| Pricing Mechanism | Multiple Price |

Note: The Government of the Republic of Kosovo reserves the right to re-purchase this Issue through operations defined in the Regulation for Primary and Secondary Market of Government Securities.

## Objava Aukcije Hartija od Vrednosti KV010-18

| | |
|---|---|
| Rok i Tip | 5 Godina – Drzavna Obveznice |
| Ponuđeni Iznos | €20,000,000 |
| Instrument kod | KV1212331239 |
| Datum Aukcije | 29.06.2018 |
| Datum Poravnanja | 02.07.2018 |
| Datum Dospeća | 02.07.2023 |
| Mehanizam Cene | Visestruka Cena |

Napomena: Vlada Republike Kosova ima pravo da ponovo otkupi obveznice preko operacija definisanih u Uredbi o Primarnom i Sekundarnom Tržištu Državnih Hartija od Vrednosti.

BQK/CBK Tel.: (038) 222-055 ext. 246

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Ahmet Ismaili

REPUBLIKA E KOSOVËS – MINISTRIA E FINANCAVE – THESARI – PRISHTINË/A

---

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

GJYKATA THEMELORE
C.nr.313/2012
Me dt.18.05.2018
Mitrovicë

PRISHTINË

Ne bazë të nenit 83 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të Kosovës kërkojmë të publikoni këtë,

SHPALLJE

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, në qështjen juridike të paditësit: Nimon Ibrahimi nga Mitrovica , kunder te padituve: Myrvete Hyseni dhe Refik Hamiti nga Mitrovica , tani me vendbanim te panjohur , per shkak te Vertetimit te pronesise , ne baze te nenit 79 pika 3-a e Ligjit mbi Proceduren Kontestimore te Kosoves te padituve: Myrvete Hyseni dhe Refik Hamiti iu caktohet perfaqesuei i perkoheshem Av. Halil Derguti ne Mitrovice.

Përfaqësuesi përkohshem do të përfaqësoi të paditurit në këtë çështje juridike deri sa ata apo i autorizuari i tyr të paraqiten në këtë gjykatë.

GJYQTARI,
Ragip Kadriu

---

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.79/2016

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Faton Ademi në qështjen juridike të paditësit: Kadri Rexhepi nga Mitrovive të cilin e përfaqëson Av. Safet Voca kundër të paditurve: Komuna e Mitrovicës dhe Alban Haziri, Arben Haziri dhe Brahim Haziri që të gjithë ish nga Mitrovica tani me vendbanim ta panjohur jashtë shtetit, gjykata me datën: 13.06.2018 konform nenit 79.3 të LPK-së mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. Caktohet** Av. Sheremet Ademi nga Mitrovica si përfaqësues i përkoshëm i të paditurve: Alban Haziri, Arben Haziri dhe Brahim Haziri ish nga Mitrovica tani me adresë të panjohur.

**II.** Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaquesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

**III.** Ky aktvendim në afat prej shtatë ditësh të shpallet në tabelën e shpalljes së gjykatës, të botohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe te botohet në njërën nga gazetat ditore të Kosovës apo sipas nevojës të shpallet në ndonjë menyrë tjetër të përshtatshme.

**IV.** Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm bien në barë palës paditëse.

**A r s y e t i m**

Paditësi Kadri rexhepi nga Mitrovica në Gjykatën Themelore ne Mitrovicë, ka parashtruar padi kundër të paditurve: Komuna e MItrovices dhe Xhevat Haziri me objekt të padisë vërtetim pronësie.

Gjykata ka filluar procedurën në këtë çështje kontestimore ashtu janë caktuar seancat e shqyrtimit përgaditorë dhe te paditurit: II, III dhe IV janë ftuar në adresën e dhënë nga pala paditëse ku kanë rezultuar nga fletëkthesat se janë të panjohur në atë adresë.

Në raport me këtë qështje ka dhënë deklaratë pranë noterit edhe axha I të paditurit: II, III dhe IV duke mos e kontestuar kërkesëpadinë.

Andaj gjatë seancës së shqyrtimit përgaditor me dt.30.05.2017 i autorizuari i paditesit ka propozuar që të paditurve të u caktohet përfaqësuesi i përkohshëm.

Pas shqyrtimit të propozimit të autorizuarit të palës paditëse, gjykata vlerësoi se ky propozim për caktimin e përfaqësuesit te përkohshëm të paditurës së cekur më lartë është i bazuar pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 79.3 pika a) te LPK-se, ndërsa për përfaqësues të përkohshëm bazuar në propozimin e Odës së Avokatëve të Kosovës të dt.13.06.2018 ka caktuar Av. Sheremet Ademi nga Mitrovica.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 te LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përqafuesit ligjore, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Nga se u tha më lartë konform nenit 79.3/1, neni 82.1.2 si dhe nenit 387.1 të LPK-së vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**
**C.nr.79/2016 me date 13.06.2018**

**GJYQTARI,**
**Faton Ademi**

**UDHËZIM JURIDIK –** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA


AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”
Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333